



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 12 regjistër (JR)
Datë 22.02.2019

Nr. 2 i vendimit
Datë 27.02.2020

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Rezarta Schuetz	Kryesuese
Ardian Hajdari	Relator
Albana Shtylla	Anëtare
Luan Daci	Anëtar
Sokol Çomo	Anëtar

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 27.02.2020, ora 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në Tiranë, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Mia Roessingh në momentin e shpalljes së vendimit, me Sekretare Gjyqësore Elba Arapi, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 12/2019 (JR), datë 22.02.2019, që i përket:

ANKUES: Komisioneri Publik Florian Ballhysa.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 84, datë 27.11.2018, që i përket subjektit të rivlerësimit Besnik Cani, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, nenet C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore publike, me praninë e palëve, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), dëgjoji Komisionerin Publik, i cili përfundimisht, bazuar në nenin 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, kërkoi

ndryshimin e vendimit nr. 84, datë 27.11.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit Besnik Cani dhe shkarkimin e tij nga detyra, dëgjoi subjektin e rivlerësimit Besnik Cani dhe avokatin e tij Eduard Halimi, të cilët gjatë shqyrtimit gjyqësor kërkuan lënien në fuqi të vendimit objekt shqyrtimi, por nuk ishin të pranishëm në seancën e shpalljes së vendimit, dëgjoi gjyqtarin relator të çështjes Ardian Hajdari, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Në lidhje me rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Besnik Cani (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016 ushtronte detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan. Duke qenë se subjekti i rivlerësimit ishte kandidat për Këshillin e Lartë të Prokurorisë (në vijim “KLP”), në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës dhe nenit 279, pika 1 e ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” (në vijim “ligji nr. 115/2016”), ai iu nënshtrua procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio* dhe me përparësi në kohë.
2. Më parë, në funksion të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar pranë institucioneve kompetente dhe brenda afatit ligjor, në përputhje me nenet 31, pika 1, 35, pika 1 dhe 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, përkatësisht deklaratën e pasurisë, deklaratën për kontrollin e figurës, si dhe formularin për vetëvlerësimin profesional.
3. Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) një raport të hollësishtëm dhe të arsyetuar, duke konstatuar se:
 - (i) deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin;
 - (ii) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
 - (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
 - (iv) nuk ka kryer deklarim të rremë;
 - (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.
4. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) kreu kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit kishte kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, dërgoi një raport pranë Komisionit, bazuar në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, me anë të të cilit përcaktoi se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar formularin e deklarimit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë, të plotë dhe në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 84/2016; se subjekti ka pasur të njëjtat gjeneralitete si ato që janë deklaruar në deklaratën e sipërcituar; se nuk ekzistojnë të dhëna që subjekti i rivlerësimit të ketë kontakte të papërshtatshme.
5. Grupi i punës së Prokurorisë së Përgjithshme (në vijim “GPPP”) ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit nëpërmjet rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor,

dhe ka dërguar pranë Komisionit një raport të hollësishëm për subjektin e rivlerësimit, bazuar në nenin 43 të ligjit nr. 84/2016. Sipas këtij raporti, është konkluduar se subjekti i rivlerësimit është vlerësuar shumë mirë për aftësitë profesionale, organizative, integritetin, etikën dhe angazhimin profesional.

6. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin e rivlerësimit nga ILDKPKI-ja, DSIK-ja dhe GPPP-ja, kreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, bazuar në të tria kriteret e vlerësimit (vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale) dhe mori vendimin objekt shqyrtimi nr. 84, datë 27.11.2018.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

7. Komisioni, me vendimin nr. 84, datë 27.11.2018, ka vendosur: “Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Besnik Cani, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan”.

7.1. Në zbatim të pikës 4 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka përcjellë disa çështje/praktika pranë organit kompetent për inspektimin e shkeljeve të mundshme disiplinore, si më poshtë vijojnë.

a. Praktika e marrëdhënies juridiko-civile ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me shoqërinë “{***}” ShPK.

b. Çështja me nr. {***}, e vitit 2006, pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

c. Dosja e procedimit penal nr. {***}, e vitit 2012, pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier, së bashku me praktikën për përfitimin e statusit të pastrehë, në bazë të Vendimit të Këshillit Bashkiak Fier, nr. {***}, datë 28.03.2013.

ç. Çështja me nr. {***}, e vitit 2015, pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

8. Ky vendim është marrë bazuar në nenet 58, pika 1, germa “a” dhe 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, në vijim të konkluzioneve të mëposhtme, për secilin prej tri kriterëve të rivlerësimit:

8.1. Në lidhje me vlerësimin e pasurisë së subjektit

i. Ka kryer pasaktësi në deklaratimet periodike, por pa pasur si qëllim apo si pasojë fshehje të pasurisë, apo mosdeklarimin e burimit financiar të përdorur për blerjen e ndonjë pasurie.

ii. Kanë rezultuar disa mangësi të burimeve financiare, për një total të akumuluar në pesë vite (dhe të shpërndara në harkun kohor 11-vjeçar), në shumën prej 819.812 lekësh, të cilat konsiderohen jo të mjaftueshme që të passjellin aplikimin e pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

iii. Nuk është konstatuar fshehje pasurie.

8.2. Në lidhje me kontrollin e figurës së subjektit

i. Rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar formularin e deklaratimit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi.

ii. Nga analiza e të dhënave të parashikuara në pikën 1, neni 38 i ligjit nr. 84/2016, dhe kryesisht bazuar në raportin e DSIK-së, rezultoi që subjekti i rivlerësimit nuk ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

iii. Nga rivlerësimi i kryer nga Komisioni, nuk u konstatua asnjë element që mund të çonte në prova apo në dyshime të arsyeshme mbi ekzistencën e mundshme të kontakteve të

papërshatshme të subjektit të rivlerësimit me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo mbi mangësi në integritetin e subjektit në fjalë dhe, për rrjedhojë, konkludohet se z. Besnik Cani është i përshtatshëm për vazhdimin e detyrës.

8.3. *Në lidhje me vlerësimin e aftësive profesionale, rezultoi se, pavarësisht vlerësimit pozitiv të Grupit të Punës së Prokurorisë së Përgjithshme, Komisioni ka konstatuar disa problematika lidhur me aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit, si dhe disa dyshime të arsyeshme në lidhje me etikën, të cilat gjithsesi nuk janë të mjaftueshme për të konkluduar se z. Besnik Cani nuk arrin një nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive të tij profesionale dhe, për këtë arsye, trupi gjykues çmon që, në zbatim të pikës 4 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, të përcjellë të gjitha praktikat/dosjet/aktet me dyshime apo problematika, pranë organit kompetent për inspektimin e shkeljeve të mundshme disiplinore.*

III. Shkaqet e ankimit

9. Komisioneri Publik Florian Ballhysa (në vijim “Komisioneri Publik”) ushtroi ankim ndaj vendimit të Komisionit nr. 84, datë 27.11.2018, për subjektin e rivlerësimit, duke konsideruar se ndryshe nga sa disponon Komisioni për kriteret e rivlerësimit, referuar gjendjes se fakteve dhe provave në rastin konkret, Komisioneri Publik ndan qëndrim të kundërt, pasi vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për konfirmimin e tij në detyrë.

10. Komisioneri Publik kërkon që shkaqet e këtij ankimi t’i marrë në shqyrtim Kolegji i Posaçëm i Apelit dhe, në zbatim të nenit 66, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, në përfundim të shqyrtimit të çështjes në seancë publike, të vendosë:

○ *Ndryshimin e vendimit nr. 84, datë 27.11.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Besnik Cani.*

11. Shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik paraqiten në mënyrë të përmbledhur, si më poshtë.

11.1. Në lidhje me pasurinë apartament banimi me sipërfaqe 104,77 m², me nr. pasurie {***}, fituar me anë të kontratës së shitjes nr. {***} rep., {***} kol., datë 18.07.2008, me adresë: rr. “{***}” Tiranë, me vlerë sipas kontratës 8.308.261 lekë, Komisioneri Publik e bazon pretendimin e tij në mospërputhjet e konstatuara nga vlerësimi i deklaratës *vetting*, deklarimeve periodike vjetore dhe akteve të tjera të administruara gjatë hetimit administrativ nga Komisioni, lidhur me origjinën e pasurisë, vlerën e saj dhe burimin e krijimit, mospërputhje këto të cilat, sipas dokumentacionit të administruar në fashikullin gjyqësor, nuk mund të justifikohen dhe për të cilat subjekti i rivlerësimit, sipas Komisionerit Publik, edhe pasi iu kalua barra e provës sipas nenit 52 nga Komisioni, nuk arriti të provojë me prova dhe shpjegime bindëse të kundërtën e rezultateve të hetimit. Gjithashtu, pretendime ngrihen edhe në raport me pamjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie.

11.1.1. Në vlerësimin e Komisionerit Publik, subjekti nuk ka deklaruar datën dhe nuk qartëson mënyrën e marrjes së huave dhe as atë të shlyerjes së tyre, duke pamundësuar kontrollin financiar dhe ligjor të kësaj marrëdhënieje, përkundër detyrimit që ligji i njej. Gjithashtu, nga përgjigjet e pyetësorëve të administruar në dosje konstatohen deklaratat kontradiktore lidhur me këto huamarrje, fakt që ngre dyshime mbi vërtetësinë e deklarimeve në to.

11.1.2. Mbi kursimet në shumën 1050000 lekë, deklaruar si burim krijimi për asetin, Komisioneri Publik pretendoi se subjekti nuk ka pasur mundësi financiare deri në datë 01.09.2005, kur është paguar kësti i parë i kontratës së sipërmarrjes, të kursejë shumën e deklaruar. Nga analiza financiare e Komisionerit Publik, subjekti i rivlerësimit rezulton me një balancë negative prej 621085 lekësh.

11.1.3. Gjithashtu, Komisioneri Publik vlerëson se referenca e Komisionit të parimi i “proporcionalitetit” për të justifikuar moszbatimin e nenit 61/3 të ligjit nr. 84/2016, në argumentimin e vendimit për pasurinë e parë, sikundër dhe në pjesë të tjera të vendimit, është bazuar në një interpretim të gabuar të normativës kushtetuese dhe ligjore.

11.2. Lidhur me pasurinë truall me sipërfaqe 633,8 m², me nr. pasurie {***}, regjistruar me certifikatën nr. {***}, lëshuar më datë 31.08.2009, fituar me anë të kontratës së shitjes nr. {***} rep., {***} kol., datë 08.06.2009, të lidhur me Agjencinë e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave/Ndërtimeve Informale (në vijim “ALUIZNI”), me vendndodhje në {***}, Tiranë, me vlerë sipas kontratës 721400 lekë (parcelë ndërtimore) dhe 30732 lekë (taksë ndikimi në infrastrukturë), Komisioneri Publik pretendoi se ka mungesë deklarimi të posedimit të tokës në periudhën 2003 – 2007, ka mospërputhje midis deklaramëve të subjektit lidhur me sipërfaqen e tokës dhe shtëpisë, të vetëdeklaruar për legalizim, si dhe mbi periudhën e ndërtimit të shtëpisë në fjalë, si dhe ka mospërputhje midis sasisë së sipërfaqes së kërkuar për legalizim, sipas referencave të sipërfaqes të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, dhe sipërfaqeve të legalizuara konkretisht.

11.2.1. Komisioni nuk ka zbatuar drejt kriteret e nenit 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, pasi u ka dhënë fuqi të plotë provuese deklaratave noteriale dhe nuk ka arsyetuar bazueshmërinë e këtij qëndrimi, duke analizuar objektin e provueshmërisë së deklaratave noteriale në harmoni me prova dhe indicie të tjera të administruara. Deklaratat noteriale rezultojnë se datojnë pas dorëzimit të deklaratës *vetting*, janë administruar gjatë hetimit administrativ dhe, si të tilla, ashtu sikurse edhe pretendimet e paraqitura nga subjekti, mbeten në nivel deklarativ.

11.3. Për pasurinë automjet tip “Mercedes Benz”, blerë nga subjekti i rivlerësimit Besnik Cani në vitin 2012, me kontratën e shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 25.01.2012, prodhim i vitit 2006, me vlerë 1300000 lekë, Komisioneri Publik pretendoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar burimin e krijimit të pasurisë në Deklaratën e Interesave Privatë të Pasurisë (në vijim “DIPP”) të vitit 2012.

11.4. Për pasurinë “garazh”, me nr. pasurie 387, datë 25.04.2012, sipërfaqe 18,7 m², në pallatin e shoqërisë “{***}” ShPK, rr. “{***}” Tiranë, blerë me kontratën nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 10.04.2012, me vlerë 7000 euro, Komisioneri Publik pretendoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar burimin e krijimit të pasurisë në DIPP-në e vitit 2012.

11.5. Lidhur me analizën financiare të të ardhurave dhe shpenzimeve të subjektit të rivlerësimit për periudhën deri në vitin 2015, Komisioneri Publik pretendoi se subjekti i rivlerësimit nuk mbulon me të ardhura të ligjshme shpenzimet dhe investimet gjatë viteve 2010 – 2015, për një diferencë totale negative prej 2.152.963 lekësh.

11.6. Në lidhje me kontratën me nr. {***} rep. dhe nr. {***} kol., datë 27.01.2016, sipas së cilës subjekti i rivlerësimit ka dhënë me qira truallin e ndodhur në {***}, Tiranë, në favor të shoqërisë “{***}” ShPK, Komisioneri Publik ka vlerësuar se subjekti ndodhet në kushtet e mosarritjes së

nivelit minimal kualifikues, referuar etikës dhe aftësive profesionale të tij. Si rrjedhojë, në konsideratë të qëllimit të nenit 179/b, pika 1 e Kushtetutës, kërkesave të nenit E të Aneksit të Kushtetutës, neneve 59, 61, pikat 4 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016 dhe, për atë që zbatim, ligjit nr. 96/2016, mangësitë e konstatuara sjellin një përfundim të ndryshëm në lidhje me konfirmimin në detyrë të subjektit.

11.6.1. Kontrata e qirasë e lidhur mes subjektit të rivlerësimit Besnik Cani dhe shoqërisë “{***}” ShPK, edhe pse *de jure* është emërtuar si “kontratë qiraje”, *de facto*, për vetë elementet që ajo përmban, konsiston në një marrëdhënie tregtare, ku subjekti është pjesëmarrës në fitimin e shoqërisë për atë pjesë të kapitalit, sipas përcaktimeve në kontratë. Nga kjo marrëdhënie juridike, subjekti i rivlerësimit ka gjeneruar të ardhura, të cilat në vitin 2017 përbëjnë rreth 70% të të ardhurave të familjes së subjektit për vitin 2017.

11.6.2. Gjithashtu, në vlerësimin e Komisionerit Publik, qëndrimi i Komisionit është kontradiktor dhe jobindës, nisur nga krahasimi i marrëdhënies kontraktuale me subjektin nga njëra anë dhe nga krahasimi i kontratave të shoqërisë “{***}” ShPK me qiradhënës të tjerë, referuar kontratave të administruara në cilësinë e provës, të pretenduara të ngjashme nga Komisioni. Komisioneri Publik pretendoi se është aspekti financiar tipar dallues i kësaj marrëdhënieje juridiko-civile, por elementi që është më i rëndësishëm, që duhet të gjejë adresim në lidhje me procesin e rivlerësimit të subjektit, është vlerësimi i saj në raport me detyrimet etike të subjektit të rivlerësimit, si detyrime ligjore të tij, dhe analizimi nëse jemi përballë cenimit të tyre. Nga kjo situatë faktike, Komisioneri Publik pretendoi se ka elemente të mjaftueshme për të konkluduar se kjo marrëdhënie kontraktuale e subjektit të rivlerësimit bie ndesh me detyrimet ligjore etike të tij, të tilla që mjaftojnë për t’u interpretuar si fakte papajtueshmërie në ushtrimin e funksionit të prokurorit në rastin konkret.

11.7. Lidhur me procedimin penal nr. {***}, të datës 31.12.2012, të Prokurorisë së Rrethit Gjiqësor Fier, së bashku me praktikën për përfitimin nga programet sociale për strehim, ku figuron si përfituese edhe bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, Komisioneri Publik pretendoi se jemi përballë shkeljes së etikës së magjistratit dhe rrethanave të përfitimit të padrejtë dhe jashtë kriterëve ligjore për shkak funksioni. Elementi i rëndësishëm në analizimin e përmbushjes së standardit të etikës nga ana e subjektit, në rastin konkret është vlerësimi tërësor i fakteve dhe provave të administruara, që nëpërmjet kalimit të barrës së provës, organi rivlerësues të tejkalojë çdo dyshim të arsyeshëm nëse subjekti me veprimet apo mosveprimet e tij ka cenuar rregullat etike profesionale, figurën e magjistratit e, për rrjedhojë, besimin e publikut, referuar nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

11.7.1. Komisioneri Publik pretendoi se përfitimi jashtë kriterëve ligjore nga programet sociale për strehim i familjes së subjektit në qytetin e Fierit, ndërkohë që ky i fundit ushtronte funksionin e drejtuesit të prokurorisë në këtë qytet, që po hetonte të njëjtat subjekte shtetërore për shpërdorim detyre dhe falsifikim dokumentesh në trajtimin e familjeve me kredi të lehta, është rrjedhojë e përfitimit të padrejtë për shkak funksioni dhe bie ndesh me përmbushjen e standardeve të etikës profesionale.

11.8. Lidhur me procedimin nr. {***} të vitit 2006, regjistruar pranë Prokurorisë së Rrethit Gjiqësor Tiranë, Komisioneri Publik pretendoi se konkluzioni i Komisionit për këtë çështje nuk u përgjigjet rrethanave të faktit konkret dhe është rezultat i zbatimit të gabuar të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016. Mbetet e paqartë metodologjia e përdorur nga Komisioni në arritjen e përfundimit se

subjekti [...] arrin më së paku nivelin minimal kualifikues, kur ndërkohë Komisioni ka konstatuar se subjekti shfaq modele të njëjta pune, të përsëritura, me problematika të ngjashme dhe për dy raste të tjera të denoncuar. Në vlerësimin e Komisionerit Publik, nëse gjetjet dhe mangësitë e konstatuara do t'i nënshtroheshin vlerësimit sipas këtij kuadri rregullator, subjekti rezulton me mangësi të njëjta, të përsëritura për të paktën (i) aftësitë profesionale; (ii) aftësitë organizative dhe (iii) arsyetimin ligjor, shkaqe këto të cilat në vlerësimin e Komisionerit Publik çojnë në zbatimin e nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

11.9. Lidhur me procedimin penal nr. {***}, të vitit 2015, regjistruar pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan, Komisioneri Publik pretendoi se konstatohen mangësi profesionale në kryerjen e hetimeve të thëlluara, cilësim korrekt i veprës penale dhe referim i gabuar i dispozitës që gjen zbatim në rastin konkret. Përtej pranisë së elementeve të figurës së veprës penale të kanosjes, fakt ky i pohuar edhe nga subjekti në arsyetimin e tij, rezulton se është injoruar prania e elementeve penale edhe për një vepër tjetër, atë të fyerjes, duke konsideruar gabimisht se ajo mund të ndiqet kryesisht nga i dëmtuari akuzues, sipas nenit 59 të Kodit të Procedurës Penale (në vijim "K.P.P."). Marrë në konsideratë se pushimi i hetimeve ndaj denoncimit të një prokurori, referuar kualifikimit të gabuar të veprës penale dhe arsyetimit ligjor, vendim i dhënë nga drejtuesi i prokurorisë, në kuadër të rivlerësimit të aftësive profesionale, merr rëndësi dhe peshë edhe më të madhe.

11.10. Komisioneri Publik ankon edhe faktin nëse Komisioni mundet të heqë dorë nga juridiksioni i tij rivlerësues në lidhje me vlerësimin e kriterit profesional, kur sipas Kushtetutës, Aneksit të saj dhe ligjit nr. 84/2016 është kompetencë e plotë dhe detyrë e Komisionit kryerja e rivlerësimit kalimtar të subjekteve për qëllim të nenit 179/b, pika 1 e Kushtetutës. Përpara se Komisioni t'ia transferojë çështjet një tjetër organi kompetent për inspektim, kjo vendimmarrje duhet të udhëhiqet nga një proces paraprak vlerësimi lidhur me plotësimin e kushteve që neni 59, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 kërkon, si: "evidentimin e shkaqeve që përbëjnë shkelje disiplinore" apo "shkaqeve për t'u marrë parasysh gjatë vlerësimit periodik të subjektit". Në çdo rast, kjo lloj vendimmarrjeje e Komisionit, sipas nenit 59, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, a do të duhet të kufizohet në lidhje me numrin e çështjeve/praktikave që mund t'i transferohen organit kompetent për inspektim.

IV. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit

A. Mbi procesin gjyqësor në Kolegji

i. Juridiksioni i Kolegjit

12. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve të parashikuara nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për rivlerësimin e subjektit të rivlerësimit, duke e konfirmuar atë në detyrë, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

ii. *Legjitimimi i ankuesit*

13. Ankuesi legjitimohet *ratione personae* në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis* pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

iii. *Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit*

14. Në përputhje me nenin 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga Komisioneri Publik, kryhet në seancë publike. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e ankimit të Komisionerit Publik ndaj vendimit të Komisionit nr. 84, datë 27.11.2018, për subjektin e rivlerësimit, u mor në shqyrtim nga Kolegji në seanca gjyqësore publike, të zhvilluara në prani të palëve.

B. Mbi aspektet procedurale lidhur me provat dhe kërkesat e Komisionerit Publik dhe atyre të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit gjatë shqyrtimit gjyqësor, Kolegji konstaton si më poshtë.

15. Subjekti i rivlerësimit në seancën e datës 20.01.2020, paraqiti kërkesë paraprake, ku kërkoi mospranimin e ankimit sa u përket katër çështjeve që Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka vendosur t'ia përcjellë organit kompetent për inspektimin e shkeljeve të mundshme disiplinore. Nëpërmjet kësaj kërkesë, subjekti i rivlerësimit pretendoi se ky ndalim është për të gjitha palët në proces, kjo në kuadër të *parimit të barazisë së armëve*, si dhe *parimit të aksesit në gjykatë*. Sipas subjektit, parashikimi i nenit 59, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 është shumë i qartë dhe nuk lë ekuivoqe për interpretime subjektive, sipas pozicionit të palëve. Qëllimi i legjislatorit në këtë rast ka qenë garantimi i një procesi rivlerësimi të shpejtë dhe efektiv dhe, në përfundim të kërkesës paraprake të paraqitur në seancë, subjekti i rivlerësimit kërkoi mospranimin e ankimit sa u përket katër çështjeve që Komisioni ka vendosur t'ia transferojë organit kompetent për inspektimin e shkeljeve të mundshme disiplinore.

15.1. Në lidhje me pranueshmërinë e ankimit, Komisioneri Publik, në ankim shprehet se neni 59, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 në lexim të parë duket sikur ndalon të drejtën e ankimit në rastet kur gjen zbatim në dispozitivin e vendimit të Komisionit. Në rastin konkret, ku Komisioni ka transferuar 4 çështje/praktika pranë organit kompetent për inspektimin e shkeljeve të mundshme disiplinore, Kolegji arsyeton se kjo dispozitë nuk i shtrin efektet e saj edhe ndaj së drejtës kushtetuese të ushtrimit të ankimit nga Komisioneri Publik. Ndalimi i parashikuar nga neni 59, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, për mosushtim ankimi, i shtrin efektet e tij vetëm mbi palët që marrin pjesë në hetimin administrativ të kryer nga Komisioni, saktësisht vetëm mbi subjektin e rivlerësimit. Ky ndalim vjen si balancim i disponimit mbi vendimin, ku nga njëra anë është vendosur për konfirmimin në detyrë dhe nga ana tjetër përmban si kusht referimin e një çështjeje në organet kompetente për shqyrtim, në rast se evidentohen shkaqe të mundshme për shkelje disiplinore. Kur Komisioneri Publik, si një ndër organet rivlerësuese dhe përfaqësues i interesit publik, i cili nuk merr pjesë në procesin e rivlerësimit të zhvilluar në Komision, çmon se vendimmarrja e Komisionit rast pas rasti nuk është në pajtueshmëri me ligjin dhe provat, apo subjekti i rivlerësimit nuk është në kushtet që duhet të konfirmohet në detyrë, ka të drejtën kushtetuese ta ankimojë vendimin pranë Kolegjit. Në seancën e datës 20.01.2020, në lidhje me

këtë kërkesë paraprake të subjektit të rivlerësimit, Komisioneri Publik pretendoi se ankimi është bërë për të tria kriteret e rivlerësimit: për vlerësimin e kriterit të pasurisë, vlerësimin e kriterit të figurës dhe vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale, duke sjellë në vëmendje që institucionet e rivlerësimit kanë të drejtë të disponojnë dhe në funksion të vlerësimit të përbashkët të të tria kriterëve dhe, në këtë këndvështrim, Komisioneri Publik e vlerëson pretendimin e subjektit të rivlerësimit si jo të bazuar në ligj, për sa kohë ankimohen të tria kriteret e rivlerësimit, për sa kohë në secilin prej kriterëve të rivlerësimit mund të ketë shkaqe të cilat, jo për njërin nga kriteret, por të marra në shqyrtim të tria së bashku, mund të përbëjnë shkak për shkarkimin e tij nga detyra.

15.2. Kolegji vëren se neni 59, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, përcakton: *Pavarësisht se subjektit të rivlerësimit i jepet vendim për konfirmimin në detyrë, Komisioni ka të drejtë të transferojë çështjen pranë organit kompetent për inspektim (i) në rast se evidenton shkaqe që përbëjnë shkelje disiplinore, sipas legjislacionit që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve, (ii) ose në rast se evidenton shkaqe për t'u marrë parasysh gjatë vlerësimit periodik të tij. Ndaj këtij vendimi nuk mund të bëhet ankim. Organi kompetent fillon menjëherë shqyrtimin e shkaqeve, sipas legjislacionit që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve.*

15.3. Nga leximi i parë literal i kësaj dispozite, duket sikur ndalimi i së drejtës së ankimit në rastet kur neni 59, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 ka gjetur zbatim në dispozitivin e vendimit të Komisionit, sikurse është edhe rasti konkret, ku Komisioni ka transferuar 4 çështje/praktika pranë organit kompetent për inspektimin e shkeljeve të mundshme disiplinore, i shtrin efektet e tij dhe ndaj së drejtës kushtetuese për ushtrimin e ankimit nga Komisioneri Publik, por siç do të arsyetohet në vijim, pretendimet në kërkesat e subjektit të rivlerësimit dhe të avokatit të tij për mospranimin e ankimit sa u përket katër çështjeve që Komisioni ka vendosur t'ia përcjellë organit kompetent për inspektimin e shkeljeve të mundshme disiplinore, janë të gabuara.

15.4. Kolegji vlerëson të drejtë pretendimin e Komisionerit Publik se ndalimi i parashikuar nga neni 59, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, për mosushtrim ankimi, i shtrin efektet e tij vetëm mbi palët që marrin pjesë në hetimin administrativ të kryer nga Komisioni, deri në përfundim të hetimit dhe shpalljen e vendimit përkatës për subjektin e rivlerësimit. Kjo dispozitë gjen zbatim në rastet kur subjekti është konfirmuar në detyrë për efekt të përfundimit të procesit kalimtar të rivlerësimit, por ndërkohë nga ana e Komisionit janë evidentuar shkaqe që mund të përbëjnë shkelje disiplinore, të cilat organi rivlerësues i konsideron jo të asaj shkalle dhe rëndësie, sa të vetme e në mënyrë të pavarur, sipas nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, apo nga vlerësimi tërësor i çështjes sipas nenit 61, pika 5 e këtij ligji, të përbëjnë shkak shkarkimi për subjektin e rivlerësimit, referuar nenit 58, pika 1, germa “c” dhe nenit 59, pika 2, lidhur me nenin 61, pika 4, si dhe me nenin 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

15.5. Parashikimi i pikës 4, të nenit 59, përveçse adreson të drejtën e organit rivlerësues, që rast pas rasti të referojë çështje pranë organit kompetent për inspektim në kushtet e mësipërme, njëkohësisht parashikon dhe ndalimin e së drejtës së ankimit për subjektin e rivlerësimit. Ky ndalim është proporcional dhe në balancë me të drejtat e subjektit, për sa kohë me transferimin e çështjes për shqyrtim organit kushtetues që gëzon juridiksionin disiplinor, subjekti i rivlerësimit do t'i nënshtrohet një tjetër procedure inspektimi disiplinor dhe vlerësimi eventual pranë organit kushtetues. Përgjatë kryerjes së këtyre procedurave të hetimit disiplinor, sikundër Kushtetuta dhe ligji urdhëron, subjektit të rivlerësimit i garantohen të gjitha të drejtat për një proces të rregullt ligjor, përfshirë të drejtën për ushtrimin e ankimit ndaj një vendimi eventual që e disponon

marrjen e një mase disiplinore administrative. Nga ana tjetër, në interpretim të Kushtetutës, ligjit të posaçëm, por dhe frymës së rekomandimeve të dhëna nga Komisioni i Venecias, vendosja e këtij ndalimi (mosushtrimi i së drejtës së ankimit) nga ligjvënësi është materializim i nevojës që procesi i rivlerësimit, referuar nenit 4, pika 3¹ e ligjit nr. 84/2016 të jetë një proces efektiv dhe i shpejtë në kohë, duke pamundësuar që subjektet e konfirmuara në detyrë nga ana e Komisionit, të mos venë në lëvizje juridiksionin rivlerësues të Kolegjit, vetëm për shkak të transferimit të praktikës organit kushtetues përgjegjës për procedimin disiplinor.

15.6. Është e qartë se ndalimi i parashikuar në nenin 59, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, nuk mund të veprojë mbi kufizimin e zbatimit të të drejtës kushtetuese për të ushtruar ankim, që i është njohur Komisionerit Publik sipas nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Kur Komisioneri Publik, si një ndër organet rivlerësuese dhe përfaqësues i interesit publik, në referencë të nenit 179/b të Kushtetutës, çmon se vendimmarrja e Komisionit rast pas rasti nuk është në pajtueshmëri me ligjin dhe provat, apo subjekti i rivlerësimit nuk është në kushtet që duhet të konfirmohet në detyrë, ka të drejtën kushtetuese ta ankimojë vendimin pranë Kolegjit.

15.7. Në funksion të nenit C, pika 2² e Aneksit të Kushtetutës, Komisioneri Publik në mbrojtje të interesit publik, siç është rasti, ushtron ankim kundër vendimit të Komisionit. Si rrjedhojë, Kolegji arrin në konkluzionin se kërkesa e subjektit të rivlerësimit për mospranimin e ankimit nuk u gjet e bazuar.

- 16.** Në të njëjtën seancë të datës 20.01.2020, subjekti i rivlerësimit paraqiti një tjetër kërkesë paraprake nëpërmjet së cilës kërkoi pezullimin e procesit të rivlerësimit deri në përfundim të mandatit si anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, duke i bashkëngjitur kërkesës edhe provat³ në poshtëshënim. Në këtë kërkesë, subjekti i rivlerësimit parashtroi se me emërimin e tij si anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë (në vijim “KLP”), nuk ushtron më detyrën e prokurorit, po ashtu marrëdhënia financiare i ndërpritet me Prokurorinë e Elbasanit duke filluar në institucionin e KLP-së, si rrjedhojë, sipas subjektit të rivlerësimit, statusi i tij si prokuror është pezulluar deri në momentin e mbarimit të mandatit.

16.1. Në lidhje me këtë kërkesë, Komisioneri Publik u shpreh në seancën e datës 20.01.2020 se nuk gjen në funksion të nenit 4, pika 6⁴ e ligjit nr. 84/2016 dhe nenit⁵ 297 të Kodit të Procedurës

¹ *Procesi i rivlerësimit fillon menjëherë, me hyrjen në fuqi të këtij ligji. Kur çështja është gati për të u shqyrtuar, institucionet e rivlerësimit vendosin brenda një afati sa më të shpejtë të mundshëm.*

² *Dy komisionerë publikë përfaqësojnë interesin publik dhe mund të paraqesin ankim kundër vendimit të Komisionit.*

³ *1. Shkresë e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan me nr. {***} prot., datë 17.12.2019, drejtuar z. Besnik Cani, me lëndë “Kthim përgjigje dhe dërgim aktesh”. Kësaj shkrese i janë bashkëlidhur këto shkresa:*

*2. Shkresë nr. {***} prot., datë 21.02.2019, e Prokurorisë së Përgjithshme.*

*3. Urdhër nr. {***}, datë 21.02.2019 (nr. {***} prot., datë 21.02.2019) i Prokurorit të Përgjithshëm.*

*4. Shkresë nr. {***}, datë 29.10.2019, e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, vendim nr. {***}, datë 11.10.2019, i Këshillit të Lartë të Prokurorisë.*

*5. Shkresë nr. {***} prot., datë 15.01.2019, e Prokurorisë së Përgjithshme, vendim “Për rezultatin e zgjedhjeve dhe shpalljen e fituesve” të Komisionit të Votimit e Mbledhjes së Përgjithshme të Prokurorëve, datë 11.12.2018.*

*6. Shkresë nr. {***} prot., datë 15.07.2015, e Prokurorisë së Përgjithshme, urdhër nr. {***}, datë 15.07.2015, i Prokurorit të Përgjithshëm, urdhër nr. {***}, datë 15.07.2015, “Për dhënie shtesë page për vështrësi pune”.*

7. Lista emërore e punonjësve të Prokurorisë Elbasan për vitin 2019.

⁴ *“Kur është rasti, institucionet e rivlerësimit mund të zbatojnë edhe procedurat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative ose në ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, nëse këto procedura nuk janë parashikuar nga dispozitat e Kushtetutës ose të këtij ligji”.*

Civile (në vijim “K.P.C.”), referimin në shkakun konkret ligjor që do të passillte pezullimin e gjykimit për efekt të kësaj kërkesë.

16.2. Kolegji shqyrtoi vendimin e Komisionit që i përket subjektit të rivlerësimit, mbi bazën e ankimit të paraqitur nga Komisioneri Publik, si institucion që legjitimohet nga neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, për të vënë në lëvizje Kolegjin duke pasur parasysh qëllimin e ligjit nr. 84/2016, si dhe bazuar në dispozitat kushtetuese për rivlerësimin kalimtar të të gjitha subjekteve të rivlerësimit për të garantuar funksionimin e shtetit të së drejtës, pavarësisë së sistemit të drejtësisë dhe rikthimin e besimit të publikut në institucionet e këtij sistemi. Si rrjedhojë, sipas parashikimeve të nenit 179/b të Kushtetutës, procesit të rivlerësimit i nënshtrohen të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët në Republikën e Shqipërisë. Në këto kushte, subjekti filloi procesin e rivlerësimit si prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe e përfundoi këtë proces si anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

16.3 Sipas nenit 1, pika 2 e ligjit nr. 96/2016 përcaktohet se statusi gëzohet ligjërisht nga një person që sapo emërohet në funksion dhe përfundon me mbarimin e statusit të magjistratit. Emërimi i subjektit të rivlerësimit në Këshillin e Lartë të Prokurorisë nuk passjell mbarimin e statusit të prokurorit. Si rrjedhojë, në kuptim të nenit 2, germat “g” dhe “gj”, si dhe neni 164, pika 1 e ligjit nr. 96/2016, subjekti i rivlerësimit vazhdonte ta gëzonte *ipso jure* statusin e magjistratit, të cilin vijoi ta ketë edhe pas emërimit si anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Bazuar në nenin 2, germa “e” e ligjit nr. 96/2016 parashikohet se “i emëruar” është personi i cili është diplomuar nga Shkolla e Magjistraturës dhe është emëruar si magjistrat nga Këshilli ose një ish-gjyqtar ose prokuror që është riemëruar nga Këshilli, por nuk është caktuar ende në pozicion. Në nenin 39 të këtij ligji parashikohen kriteret për caktimin në pozicion të magjistratëve të emëruar. Pra, ligji e ndan konceptin e “emërimit si magjistrat” dhe “magjistratit në detyrë apo pozicion” si në rastin e subjektit, i cili edhe pse nuk ushtron detyrën e magjistratit, vijon të ketë emërimin dhe statusin e magjistratit. Rastet e mbarimit të statusit të magjistratit dhe procedura parashikohen në nenet 64 dhe 65 të ligjit nr. 96/2016, ndaj emërimi i subjektit si anëtar i KLP-së nuk prezumon mbarimin e statusit të magjistratit.

16.4 Për ta lidhur me analizën më sipër, vërtetimi nr. {***} prot., datë 15.01.2019, i Prokurorisë së Përgjithshme, ku vendimi “Për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, datë 11.12.2018, i njoftohet për subjektin e rivlerësimit Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, provon që ai nuk është më magjistrat/prokuror në pozicionin e prokurorit në Prokurorinë Elbasan, por nuk provon që ai ende nuk është i emëruar si magjistrat prokuror. Për rastet të cilat nga përkatësia e kompetencave parashikohen në nenin 160, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, për të cilat në mungesë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, kompetencat i merr Prokuroria e Përgjithshme, nga subjekti i rivlerësimit nuk u paraqit një akt i Prokurorit të Përgjithshëm, nëpërmjet të cilit të deklarohet se për të kishte mbaruar statusi si magjistrat.

⁵ “Gjykata vendos pezullimin e gjykimit kur: a) çështja nuk mund të zgjidhet para se të zgjidhet një çështje tjetër penale, civile ose administrative; b) kërkohet nga të dyja palët; c) njëra nga palët vdes ose mbaron personi juridik; ç) njëra nga palët nuk ka ose më vonë ka humbur zotësinë juridike për të vepruar si palë dhe shihet e nevojshme t’i emërohet një përfaqësues ligjor; d) parashikohet shprehimisht në ligj. Gjatë pezullimit nuk mund të kryhen veprime procedurale”.

16.5. Kolegji, në analizë të sa më sipër, për sa i përket kërkesës së subjektit të rivlerësimit për pezullimin e procesit të rivlerësimit deri në mbarim të mandatit të subjektit në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, me vendim të ndërmjetëm, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës, në Aneksin e Kushtetutës në tërësinë e vet dhe duke iu referuar nenit 4, pika 6 dhe nenit 65 të ligjit nr. 84/2016, ligjit nr. 96/2016, si dhe duke gjetur se nuk gjendemi në kushtet e nenit 297 të K.P.C., vendosi rrëzimin e kërkesës së subjektit të rivlerësimit.

17. Në seancën e datës 20.01.2020, subjekti i rivlerësimit i kërkoi Kolegjit marrjen dhe shqyrtimin në seancë gjyqësore të provave të listuara si më poshtë.

- Urdhër nr. {***}, datë 17.10.2010, i Prokurorisë së Përgjithshme për shpërblimin e anëtarëve të Këshillit të Prokurorisë.
- Urdhër shpenzimi nr. {***}, datë 06.12.2010, lëshuar nga Prokuroria e Përgjithshme.
- Listëpagesë e Prokurorisë së Përgjithshme për periudhën 1-31 dhjetor 2010.
- Bordero për shpërblimin e anëtarëve të Këshillit të Prokurorisë.
- Listë emërore e punonjësve të Prokurorisë së Përgjithshme.
- Bordero për shpërblimin e anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, sipas urdhrit nr. {***}, datë 30.03.2010.
- Urdhër shpenzimi nr. {***}, datë 15.04.2010, lëshuar nga Prokuroria e Përgjithshme.
- Vërtetim nr. {***} prot., datë 17.10.2019, i Institutit të Sigurimeve Shoqërore.
- Libreza e punës së babait të subjektit të rivlerësimit.
- Vërtetim page i lëshuar nga Ndërmarrja e Bonifikimit Dibër, datë 30.06.1991.
- Vërtetim i Institutit të Sigurimeve Shoqërore me nr. {***} prot., datë 17.10.2019.
- Vërtetim nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, pa nr. prot dhe pa datë, për M. C. (vëllai i subjektit).
- Vërtetim i Komunës {***} me shkrim dore, pa numër protokolli dhe me datë 10.04.1996.
- Vërtetim nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria Rajonale Dibër, me nr. {***} prot., datë 28.03.2018.
- Vërtetim nga Ministria e Financave, Shërbimi Kombëtar i punësimit DRSHPK Dibër, me nr. {***} prot., datë 27.02.2018, me anë të të cilit vërtetohet se z. I. N. është trajtuar me pagesë papunësie nga data 15.12.1991 - 15.12.1992.
- Vërtetim nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria e Arkivit Qendror, Dega e Arkivit të Rajonit Tiranë me nr. {***} prot., datë 21.05.2018, nga i cili rezulton se z. I. N. ka realizuar të ardhura në “{***}” nga tetori i vitit 1993 deri në maj të vitit 1998.
- Raport i veprimtarisë së Prokurorisë Fier për vitin 2012, pa nr. protokolli, me datë 25.01.2013, drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm.
- Analizë për punën e Prokurorisë së Rrethit Tiranë për vitin 2007, nr. {***} prot., datë 28.01.2008.
- Analizë vjetore për vitin 2015 e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan, nr. {***} prot., datë 17.12.2019.

18. Në seancën publike të zhvilluar më datë 11.02.2020, avokati Eduard Halimi kërkoi pezullimin e gjykimit të çështjes me numër 12/2019, datë 22.02.2019, që lidhet me procesin e rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit Besnik Cani, deri sa të bien shkaqet e pezullimit, konkretisht përfundimi i hetimit penal me vendim të formës së prerë, për fajësi apo për pafajësi, dhe

përfundimin e shqyrtimit të dy kërkesave në Gjykatën Kushtetuese, nëse të dy anëtarët e trupit gjykues të Kolegjit janë zgjedhur apo jo në përputhje me Kushtetutën.

18.1. Kolegji, referuar kërkesave të mësipërme vendosi të rrezojë kërkesën e subjektit të rivlerësimit për pezullimin e gjykimit, pasi në vlerësimin e trupit gjykues të Kolegjit nuk ndodhemi në kushtet që parashikon neni 297 i K.P.C. për pezullimin e gjykimit. Për më tepër, kallëzimi penal që ka bërë subjekti i rivlerësimit për një nga anëtarët e trupit gjykues të Kolegjit dhe dy kërkesat e subjektit të rivlerësimit për mbarimin e mandatit të dy anëtarëve të trupit gjykues të Kolegjit, nuk janë shkaqe për pezullimin e procesit të rivlerësimit që zhvillohet sipas përcaktimeve të parashikuara në Kushtetutë dhe në Aneksin e saj, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Më parë subjekti i rivlerësimit ka paraqitur kërkesë për përjashtimin e dy anëtarëve të trupit gjykues të Kolegjit, kërkesë e cila është rrëzuar nga një tjetër trup gjykues.

19. Sërish, në seancën e datës 11.02.2020, Kolegji i kërkoi Komisionerit Publik të parashtronte qëndrimin e tij lidhur me tri denoncimet e ardhura nga publiku, të cilat Komisioneri Publik i ka përcjellë në datën 04.02.2020 në adresën e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, që lidhen me subjektin e rivlerësimit, të cilat më pas Kolegji në rastin më të parë i ka ndarë edhe me subjektin e rivlerësimit.

19.1. Komisioneri Publik, lidhur me tri denoncimet të cilat janë të administruara në Institucionin e Komisionerëve Publikë, dy prej të cilave janë dërguar nga Kolegji i Posaçëm i Apelit sepse ka qenë institucioni që i ka regjistruar fillimisht, ka konkluduar se çështjet që trajtohen në këto denoncime janë të tilla që nuk nevojitet një hetim i mëtejshëm në lidhje me përmbajtjen e tyre. Komisioneri Publik u qëndroi vetëm çështjeve që i ka pjesë të ankimit të tij. Kolegji, në lidhje me tri denoncimet nga z. A. M., z. M. H. dhe z. A. B., të ardhura në adresën e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, vendosi të mos hetojë më tej, pasi këto denoncime çmohet se nuk përmbushin kushtet e nenit 53 të ligjit nr. 84/2016.

C. Mbi themelin e pretendimeve sipas shkaqeve të ankimit të Komisionerit Publik

20. Në lidhje me pasurinë “**apartament banimi me sipërfaqe 104,77 m²**”, me nr. pasurie {***}, fituar me anë të kontratës së shitjes nr. {***} rep., {***} kol., datë 18.07.2008, me adresë: rr. “{***}” Tiranë, me vlerë sipas kontratës 8308261 lekë, Komisioneri Publik e bazon pretendimin e tij në mospërputhjet e konstatuara nga vlerësimi i deklaratës *vetting*, i deklarimeve periodike vjetore dhe i akteve të tjera të administruara gjatë hetimit administrativ nga Komisioni, mospërputhje këto të cilat, sipas dokumentacionit të administruar në fashikullin gjyqësor, nuk mund të justifikohen dhe për të cilat subjekti i rivlerësimit, sipas Komisionerit Publik, edhe pasi iu kalua barra e provës sipas nenit 52 nga Komisioni, nuk arriti të provojë me prova dhe shpjegime bindëse të kundërtën e rezultateve të hetimit. Gjithashtu, pretendime ngrihen edhe në raport me pamjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie. Komisioneri Publik, në ankimin e tij për këtë pasuri, pretendoi se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pamjaftueshëm, duke mos përmbushur detyrimet e pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, pasi nuk arriti të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë. Në vlerësimin e Komisionerit Publik, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar datën dhe nuk qartëson mënyrën e marrjes së huave dhe as atë të shlyerjes së tyre, duke pamundësuar kontrollin financiar dhe ligjor të kësaj marrëdhënieje, përkundër detyrimit që ligji i njej. Gjithashtu, nga përgjigjet e pyetësorëve të

administruara në dosje, konstatohen deklaratat kontradiktore lidhur me këto huamarrje, fakt që ngre dyshime mbi vërtetësinë e deklarimeve në to.

20.1. Kolegji vëren se në deklaratën *vetting* subjekti i rivlerësimit ka deklaruar për këtë pasuri si burim të krijimit: (i) kursime nga të ardhurat personale dhe të bashkëshortes; (ii) detyrimet familjare etj.; (iii) kredi bankare e marrë NBG Bank në shumën 40.000 euro; (iv) kursime ndër vite; (v) hua pa interes në shumën 6.000 euro nga baxhanaku, z. P. T., me vendbanim në Greqi. Në DIPP-në e vitit 2005, subjekti i rivlerësimit deklaroi si burim të krijimit të pasurisë: (i) 3.500 USD kursime të mbartura nga viti 2004; (ii) 6.000 euro hua, marrë nga baxhanaku në Greqi; (iii) hapje-mbyllje depozite në shumën 50.000 lekë; (iv) 500.000 lekë marrë te të afërmit pa afat dhe pa interes; (v) kursimet e vitit 2005 në shumën 1.050.000 lekë. Siç vërehet nga deklaratat e mësipërme, burimi i të ardhurave që kanë shërbyer për krijimin e kësaj pasurie, është i ndryshëm. Në deklaratën *vetting* subjekti nuk ka deklaruar saktësisht burimin e krijimit të saj, pasi nuk rezultoi të këtë deklaruar huan në vlerën 500.000 lekë, të cilën e ka deklaruar në deklaratën e interesave periodikë vjetore 2005.

20.2. Lidhur me burimin në shumën prej 3.500 USD, të mbartur nga viti 2004, rezultoi se subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2004, në rubrikën e pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme shumën 300.000 lekë, në pjesë takuese 50% dhe datë krijimi 31.12.2004. I pyetur nga Komisioni për këtë shumë, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se: *[...] në vitin 2004, kam deklaruar kursime në shumën 300.000 lekë, pa specifikuar vendndodhjen e tyre, pra nëse ishin në banesë apo në bankë. Kjo sasi prej 3.500 USD, e vendosur në sistemin bankar në vitin 2004, e ka burimin te kursimet e vitit 2004, të cilat kanë qenë të mjaftueshme për të justifikuar këtë shumë në bankë, që do të thotë se shuma 3.500 USD në bankë në fakt është pikërisht kursimi prej 300.000 lekësh dhe të tjera të deklaruara në vitin 2004.* Referuar ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i pandryshuar (në vijim “ligji nr. 9049/2003”), në nenin 4, germa “d” parashikohet si objekt deklarimi vlera e likuiditeteve, gjendje në çash, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono. Pra, referuar ligjit të kohës, subjekti i rivlerësimit kishte detyrimin ta specifikonte në DIPP-në e vitit 2004 vendndodhjen e shumës *cash* prej 300.000 lekësh, të cilën e kishte mbajtur në banesë.

20.3. Lidhur me burimin në shumën prej 50.000 lekësh, në dokumentacionin e administruar në Komision gjendet shkresa me nr. {****} prot., datë 14.12.2017, e Bankës Societe Generale Albania ShA. Sipas gjendjes së llogarisë, verifikohet se derdhja *cash* është kryer nga subjekti i rivlerësimit në datën 07.09.2005, në vlerën 50.000 lekë dhe është tërhequr në datën 30.12.2005 në vlerën 50.500 lekë. Transaksioni i tërheqjes së depozitës është kryer pas datës 01.09.2005, datë kjo kur është nënshkruar kontrata e sipërmarrjes, dhe gjithashtu është kryer pagesa e kështit të parë prej 15.000 eurosh. Duke qenë se kjo depozitë është çelur në datën 07.09.2005 dhe është tërhequr në datën 30.12.2005, sipas këtij dokumentacioni të administruar nga Komisioni, rezultoi se kjo shumë nuk ka qenë burim i pagesës së kështit të parë.

20.4. Mbi huan në shumën 500.000 lekë, subjekti i rivlerësimit në deklaratën DIPP të vitit 2005, e ka deklaruar burimin hua të marrë pa afat te të afërmit dhe pa interes, ndërsa në të njëjtën deklaratë, në rubrikën e “të dhënave që nuk publikohen”, subjekti ka deklaruar “detyrim ndaj motrave dhe vëllezërve të mi dhe të bashkëshortes”. Duke qenë se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktësisht dhe qartësisht detyrimet financiare në formë huaje, Komisioni e ka pyetur

subjektin lidhur me rrethin e personave huadhënës, për të cilët në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar se [...] këtë detyrim të krijuar, e kam ndaj baxhanakut tim P. N..

20.5. Për të vërtetuar këtë fakt, subjekti i rivlerësimit mbështetet në deklaratën noteriale të datës 31.01.2017 me nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., ku z. P. N. deklaroi se i ka dhënë hua disa herë në periudhën 2005 deri në vitin 2009, në vlerën totale prej 1.000.000 lekësh, subjektit të rivlerësimit. Në deklaratën noteriale të datës 20.03.2018 me nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., z. P. N. deklaroi se i ka dhënë hua në vitet 2005-2009 subjektit në vlerën 1.000.000 lekë, të cilën subjekti i rivlerësimit e ka shlyer. Kolegji arsyeton se, referuar jurisprudencës⁶ së tij, deklarata noteriale të tilla merren me rezervë në këtë proces, pasi janë kryer gjatë procesit të rivlerësimit dhe për shkak të tij, çka të krijoj bindjen se është konceptuar në favor të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit. Marrja me rezervë e deklaratave noteriale forcohet sidomos kur nuk mbështeten dhe nuk janë në harmoni me provat e tjera të administruara në procesin e rivlerësimit. *Sa i përket shkakut të mësipërm të ankimit të ngritur nga Komisioneri Publik, gjendet i bazuar.*

- 21.** Lidhur me shkakun e ankimit mbi kursimet në shumën 1.050.000 lekë, deklaruar si burim krijimi për pasurinë apartament banimi me sipërfaqe 104,77 m², Komisioneri Publik pretendoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mundësi financiare deri në datën 01.09.2005, kur është paguar kësti i parë i kontratës së sipërmarrjes, të kursejë shumën e deklaruar. Nga analiza financiare e Komisionerit Publik, subjekti i rivlerësimit rezultoi me një balancë negative prej 621.085 lekësh.

21.1. Kolegji vëren se mbi kursimet në shumën 1.050.000 lekë, të deklaruara si një nga burimet për pagesën e këstit të parë të apartamentit në vitin 2005, rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mundësi për të krijuar këtë kursim. Nga analiza financiare e kryer deri në momentin e pagimit të këstit të parë prej 15.000 eurosh ndaj shitësit të apartamentit, rezultoi se likuiditetet në fillim të vitit janë në vlerën 3500 USD, të konvertuara me kursin e datës 01.09.2005, të publikuar nga Banka e Shqipërisë, janë në vlerën 350.630 lekë. Të ardhurat e subjektit nga janari i vitit 2005 deri në shtator të vitit 2005 janë në vlerën 710.026 lekë. Të ardhurat e bashkëshortes së subjektit nga janari i vitit 2005 deri në shtator të vitit 2005 janë në vlerën 254.227 lekë. Në DIPP-në e vitit 2005, subjekti ka deklaruar hua nga të afërmit në vlerën 500.000 lekë. Në total likuiditetet e disponueshme të subjektit nga janari i vitit 2005 deri në momentin e pagimit të këstit të parë prej 15.000 eurosh, janë në vlerën 1.814.883 lekë. Shpenzimet e subjektit deri në shtator të vitit 2005 përbëhen nga shpenzimet për jetesë, pagesa e këstit të parë në vlerën 15.000 euro, e konvertuar me kursin e Bankës së Shqipërisë në datën 01.09.2005, të barabarta me 1.858.200 lekë, dhe likuiditetet në fund të periudhës të mbetura pas pagimit të këtij kësti, të cilat përbëjnë një total prej 2.435.968 lekë. Si rrjedhojë, diferenca mes likuiditeteve të disponueshme të subjektit në vlerën 1.814.883 lekë dhe shpenzimeve në vlerën 2.435.968 lekë rezultoi të jetë negative, në vlerën 621.085 lekë.

21.2. Në tetor të vitit 2005, subjekti i rivlerësimit kryen një pagesë tjetër ndaj shitësit të apartamentit, në vlerën 6.000 euro. Për të kryer një analizë të mundësisë financiare të pagesave të deritanishme, në total 21.000 euro, është kryer analiza financiare për vitin 2005, ku janë përfshirë likuiditetet në fillim të vitit, të ardhurat e subjektit dhe të bashkëshortes së tij nga janari deri më

⁶ Vendimi nr. 6/2018, datë 12.09.2018, paragrafët 35 dhe 36; vendimi nr 11/2019, datë 22.05.2019, paragrafi 27.12.1; vendimi nr. 34/2019, datë 02.12.2019, paragrafi 85.2.

31.12.2005, huat nga të afërmit (në këtë pikë janë përfshirë huaja e marrë nga të afërmit në vlerën 500000 lekë dhe një hua e ardhur në formën e transfertës bankare në datën 07.10.2005, në vlerën 6000 euro në NBG). Totali i likuiditeteve të disponueshme është 2950457 lekë. Gjatë vitit 2005, janë kryer shpenzime jetese, pagesa prej 21.000 eurosh, e konvertuar me kursin e Bankës së Shqipërisë në vlerën 2574180 lekë. Në llogaritë bankare gjenden likuiditetet në fund të vitit 2005. Diferenca mes likuiditeteve të disponueshme, shpenzimeve dhe pagesës së kështit të parë prej 21.000 eurosh, rezulton negative në vlerën 256889 lekë, duke i bërë të pamundura pagesat e kryera për apartamentin gjatë vitit 2005, përballimin e shpenzimeve dhe krijimin e kursimeve.

21.3. Për sa i përket kështit tjetër të paguar në datën 31.01.2006 (46.000 euro, nga të cilat 40.000 euro kredi), diferenca prej 6.000 eurosh, mbetur për t'u paguar deri më datë 31.01.2006, nuk mbulohet me të ardhurat e subjektit të rivlerësimit nga pagat, duke qenë se sipas pagave të derdhura në llogaritë bankare të subjektit dhe të bashkëshortes së tij, deri në fund të muajit janar 2006, llogaria e tyre është kredituar nga paga vetëm për vlerën 57432 lekë. Nga analiza financiare, rezulton se subjekti nuk mund të kryente pagesat për pasurinë me të ardhurat e janarit 2006 apo me kursimet e një viti më parë.

21.4. Gjatë vitit 2006 janë kryer pagesat e tjera prej 2000 eurosh, të mbetura pa u paguar dhe për këtë arsye është kryer një analizë financiare e plotë për vitin 2006.

Gjatë vitit 2006 subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij kanë pasur likuiditete të disponueshme, të përbëra nga të ardhurat e tyre nga huaja bankare dhe nga hua prej të afërmeve në vlerën 6802861 lekë. Gjatë këtij viti janë kryer shpenzime të ndryshme për kredinë, jetesë dhe udhëtime. Janë paguar 48.000 euro të mbetura nga pagesa e apartamentit, të cilat janë konvertuar me kursin e Bankës së Shqipërisë. Nga analiza financiare e vitit 2006, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mundësi financiare për të mbuluar me të ardhura të ligjshme shpenzimet, kursimet dhe pagesën e kryer në favor të shoqërisë së cituar më sipër, duke rezultuar me një diferencë negative e cila është në vlerën 127.000 lekë.

Në konkluzion, shkaku i ankimit të Komisionerit Publik gjendet i bazuar.

- 22.** Lidhur me shkakun e ankimit të Komisionerit Publik për referencën që ka bërë Komisioni të **“parimi i proporcionalitetit”** për të justifikuar moszbatimin e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, në argumentimin e vendimit për pasurinë e parë, apartament banimi me sipërfaqe 104,77 m², sikundër dhe në pjesë të tjera të vendimit, Komisioneri Publik pretendoi se është një interpretim i gabuar i normativës kushtetuese dhe ligjore.

22.1. Kolegji arsyeton se proporcionaliteti si parim vlerësohet rast pas rasti, duke pasur parasysh disa aspekte, si: balancën mes së drejtës së kufizuar dhe interesit publik ose mbrojtjes së të drejtave të të tjerëve, mjetin e përdorur në raport me gjendjen që e ka diktuar atë, të drejtën e cenuar dhe qëllimin që synohet të arrihet. Këto aspekte nuk duhet të analizohen veç e veç, por të gërshetuara me njëra-tjetrën. Neni Ç i Aneksit të Kushtetutës në pikën 2, parashikon: *Komisioni dhe Kolegji i Apelit publikojnë vendimet e tyre, si dhe çdo informacion tjetër të nevojshëm të marrë nga publiku. Këto organe marrin në shqyrtim informacione nga publiku duke respektuar parimin e proporcionalitetit midis privatësisë dhe nevojave të hetimit, si dhe duke garantuar të drejtën për një proces të rregullt.*

22.2. Nga dispozitat ligjore të parashikuara nga Kushtetuta, por edhe nga ligji nr. 84/2016, vërehet se ato i referohen aplikimit të parimit të proporcionalitetit dhe objektivitetit për zgjidhjen e çështjes në tërësi, duke synuar që në rastet objekt vlerësimi në kuadër të rivlerësimit të

subjekteve të këtij ligji, masa disiplinore e dhënë të jetë në përpjesëtim të drejtë me shkeljet e konstatuara. Në rastin e procesit të rivlerësimit, aplikimi i parimit të proporcionalitetit dhe objektivitetit nga organet e rivlerësimit i çon këto organe drejt dhënies së një mase disiplinore e cila nxjerr subjektet jashtë sistemit të drejtësisë vetëm bazuar në standarde objektive, duke u siguruar që masa e dhënë të jetë e nevojshme për të përmbushur qëllimin e ligjit, si dhe duke vlerësuar që masa e dhënë të jetë në proporcion me shkeljet e konstatuara.

22.3. Në nenin 4, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 parashikohet: *Komisioni dhe Kolegji i Apelimit ushtrojnë funksionet e tyre si institucione të pavarura dhe të paanshme, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor. Po në nenin 4, në pikën 7 të tij, parashikohet: *E drejta e informimit, e parashikuar në ligjin “Mbi të drejtën e informimit”, mund të kufizohet duke respektuar parimin e proporcionalitetit nëse dhënia e informacionit shkakton një dëm të qartë dhe të rëndë për administrimin e procesit të rivlerësimit.**

Në nenin 52, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, të “Barra e provës”, parashikohet: *Komisioni dhe Kolegji i Apelimit në shqyrtimin e çështjes udhëhiqen nga parimi i objektivitetit dhe proporcionalitetit.*

Nga analizimi i këtyre dispozitave kuptohet se proporcionaliteti është një pjesë e tërësisë së parimeve nga të cilat udhëhiqen institucionet e rivlerësimit.

Për më tepër, proporcionaliteti në kuptim të dispozitave kushtetuese dhe ligjit nr. 84/2016, kuptohet dhe vlerësohet si një kufizim/limitim në shqyrtimin informacioneve, ushtrimin e funksioneve të institucioneve të rivlerësimit, të drejtën e informimit dhe masën për barrën e provës gjatë hetimit dhe gjyqimit të çështjeve në procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

22.4 Sipas vlerësimit të Kolegjit, nuk qëndron pretendimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me aplikimin e parimit të proporcionalitetit dhe të objektivitetit, pasi në tërësinë e procesit të tij të rivlerësimit, subjekti i rivlerësimit Besnik Cani ka dështuar në disa aspekte, si: kontrolli i pasurisë (ku rezulton se ka bërë deklaram të pamjaftueshëm) dhe në vlerësimin tërësor të tij rezulton se ka cenuar besimin e publikut në sistemin e drejtësisë.

22.5. Kolegji, në konkluzion të arsyetimit të mësipërm në lidhje me pasurinë apartament banimi me sipërfaqe 104,77 m², vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka pasur mungesë të burimeve të ligjshme të të ardhurave për të kursyer gjatë viteve 2005 dhe 2006, për pasojë nuk arriti të justifikojë ligjshmërinë e burimeve për krijimin e kësaj pasurie të paluajtshme, në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016. Për këto arsye, Kolegji arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit është në kushtet e deklaramit të pamjaftueshëm, lidhur me kriterin e kontrollit të pasurisë sipas nenit 33, pika 5, shkronja “b”, dhe 61 pika 3 e ligjit nr. 84/2016, sa i takon kësaj pasurie, apartament banimi me sipërfaqe 104,77 m². Për rrjedhojë, konkluzioni i Komisionit në lidhje me këtë pasuri është i gabuar dhe për pasojë shkak i ankimit të Komisionerit Publik gjendet i bazuar.

- 23.** Lidhur me pasurinë **“truall me sipërfaqe 633,8 m²”**, me nr. pasurie {***}, regjistruar me certifikatën nr. {***}, lëshuar më datë 31.08.2009, fituar me anë të kontratës së shitjes nr. {***} rep., {***} kol., datë 08.06.2009, të lidhur me ALUIZNI-n, me vendndodhje në {***}, Tiranë, me vlerë sipas kontratës 721400 lekë (parcelë ndërtimore) dhe 30732 lekë (taksë ndikimi në

infrastrukturë), Komisioneri Publik pretendoi se ka mungesë deklarimi të posedimit të tokës në periudhën 2003 – 2007, ka mospërputhje midis deklaramëve të subjektit të rivlerësimit lidhur me sipërfaqen e tokës dhe të shtëpisë, të vetëdeklaruar për legalizim, si dhe mbi periudhën e ndërtimit të shtëpisë në fjalë, si dhe ka mospërputhje midis sasisë së sipërfaqes së kërkuar për legalizim sipas referencave të sipërfaqes të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, me sipërfaqet e legalizuara konkretisht.

Komisioni nuk ka zbatuar drejt kriteret e nenit 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, pasi u ka dhënë fuqi të plotë provuese deklaratave noteriale dhe nuk ka arsyetuar bazueshmërinë e këtij qëndrimi, duke mos analizuar objektin e provueshmërisë së deklaratave noteriale në harmoni me prova dhe indicie të tjera të administruara. Deklaratat noteriale rezultojnë se datojnë pas dorëzimit të deklaratës *vetting*, janë administruar gjatë hetimit administrativ dhe, si të tilla, ashtu sikurse edhe pretendimet e paraqitura nga subjekti, mbeten në nivelin deklarativ.

23.1. Kolegji vëren se në deklaratën *vetting* kjo pasuri deklarohet: “Truall me sipërfaqe 633,8 m²”, dhe një banesë private me sipërfaqe 112 m², pasuria me nr. {***}, me vendndodhje {***}, Tiranë. Pasuria është fituar me legalizim nga ALUIZNI në vitin 2008, me vlerë 721400 lekë (parcelë ndërtimore), 30732 lekë (taksë ndikimi në infrastrukturë), 100% në pronësi të subjektit. Në deklaratën e vitit 2003 të parafillimit të detyrës, subjekti deklaron: “Banesë private, me sipërfaqe 100 m², komuna {***}, e ndërtuar që nga viti 1995, me kosto ndërtimi 700.000 lekë”. Në këtë deklaratë, subjekti nuk e ka pasqyruar sipërfaqen e truallit. Si burim krijimi deklarohen: (i) kursime familjare dhe (ii) kursimet nga emigracioni 1993-1994. Në DIPP-në e vitit 2008, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar për herë të parë truallin: *sipërfaqe toke shtetërore prej 633,8 m² në Komunën {***}, mbi të cilën është ndërtuar banesa e deklaruar në vitin 2003, e zotëruar pa dokumente.*

23.2. Nga mospërputhjet në deklarim në lidhje me truallin, subjekti i rivlerësimit në shpjegimet pas kalimit të barrës në Komision, ka sqaruar se “në mungesë udhëzimesh të qarta dhe pa eksperiencë në deklarime, duke mos e konsideruar si të duhur më parë, e kam deklaruar atë me sipërfaqe prej 700 m² menjëherë, në momentin e nisjes së procedurës së legalizimit, pa e konsideruar më parë si një send në posedim të plotë dhe të vazhdueshëm, për të cilin mund të kisha detyrimin e deklarimit, pasi ishte informal dhe nuk dihej se çfarë qëndrimi do të mbante edhe shteti në lidhje me këtë informalitet. Sipërfaqja e deklaruar 700 m² rezultoi shumë afër asaj të konstatuar nga matjet e specialistëve të asaj fushe, prej 633,9 m², nga ku rezultoi një gabim prej 66,2 m², i shkaktuar nga diferencat midis matjes vizuale dhe matjes faktike.

23.3. Kolegji arsyeton se subjekti i rivlerësimit, bazuar në ligjin nr. 9049/2003 të pandryshuar, sipas nenit 4, germa “a”, ku objekt deklarimi janë *pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to*, ishte i detyruar të deklaronte parcelën ndërtimore, edhe pse nuk e dinte se çfarë qëndrimi do të mbante shteti me informalitetin, për shkak të zaptimeve pronësore të individëve. Pavarësisht se subjekti nuk kishte dokumentacion pronësie mbi pasurinë dhe, në pamje të parë dukej sikur do deklaronte pronën e dikujt tjetër (shtetit), të drejtat reale që subjekti kishte realizuar në lidhje me këtë pronë ishin përdorimi dhe banimi, *jus in re aliena*, të drejtat reale mbi sendin e tjetrit. Nisur nga ky parashikim ligjor, subjekti i rivlerësimit duhej ta deklaronte që në vitin 2003 parcelën ndërtimore, pavarësisht mungesës së udhëzimeve dhe mungesës së eksperiencës në deklarime, pasi një detyrim i tillë buronte nga ligji i kohës⁷.

⁷ Ligji nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”

23.4. Nga verifikimi i dokumenteve në dosje, rezulton deklarim i ndryshëm si për sipërfaqen e truallit, ashtu edhe për sipërfaqen ndërtimore (100 m² në deklarimin e vitit 2003 dhe 112 m² në deklarimin *vetting*). Në certifikatën e regjistrimit me nr. 106248, lëshuar më datë 31.08.2009, e cila ka finalizuar praktikën e ALUIZNI-t për legalizimin e kësaj pasurie, rezulton e regjistruar sipërfaqja totale 633,8 m², nga e cila, ndërtesë me sipërfaqe 112 m². Subjekti i rivlerësimit ka sqaruar në parashtrimet pas kalimit të barrës së provës nga Komisioni, lidhur me këtë diferencë në sipërfaqen e pasurisë, se ky ndërtim nuk është realizuar me një projekt paraprak, ku të ishte paracaktuar dhe saktësuar sipërfaqja për t'u ndërtuar, si dhe nuk kishte dokumente pronësie në lidhje me të, gjë që nuk mundësonte njohjen ekzakte të sipërfaqes së godinës. Kolegji vëren se subjekti i rivlerësimit, përveç pasaktësive në deklarimet e sipërcituara në sipërfaqen e truallit dhe të ndërtimit, nga dokumentacioni i gjendur në dosje rezulton se në formularin e vetëdeklarimit për legalizimin e kësaj pasurie ka deklaruar sipërfaqen e truallit 300 m², pra kemi dukshëm një reduktim të sipërfaqes së truallit, ku është deklaruar më pak se gjysma. Referuar këtyre të dhënave sipas dokumenteve në dosje, konstatohet me lehtësi ekzistenca e mospërputhjeve lidhur me sipërfaqen e pasurisë, mospërputhje këto të cilat evidentohen jo vetëm mes deklaratës *vetting* dhe asaj të vitit 2003, por edhe mes akteve të administruara në fashikull.

23.5. Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar në parashtrimet pas kalimit të barrës së provës në Komision se në nenin 17, pika 3 e ligjit nr. 9842, datë 03.04.2006, "Për legalizimin dhe urbanizimin e ndërtimeve pa leje", përcaktohet se: *Kalimi i pronësisë së parcelës ndërtimore, si rregull nuk i kalon 500 m². Sipërfaqet e truallit mbi 500 m², të cilat për shkak të përmasave ose konfiguracionit nuk mund të shfrytëzohen më vete për ndërtim, i bashkëlidhen parcelës ndërtimore dhe i shiten pronarit me çmim tregu.* Duke u nisur nga kjo dispozitë, subjekti i rivlerësimit sqaron se sipërfaqja prej 133 m² (633 m² – 500 m²) e cila rezulton përtej 500 m² të përcaktuar në nenin më sipër, është paguar me çmim tregu. Nga verifikimi i dokumentacionit në dosje, formulari i pagesës ({***}) së parcelës ndërtimore, Kolegjit nuk i rezultoi se është ndarë pagesa me dy çmime të ndryshme referuar pragut 500 m² sipas nenit më sipër, nga e cila sipërfaqja prej 133 m² të jetë trajtuar me çmim tregu. Nga ana tjetër, as në kontratën e lidhur me ALUIZNI-n nuk rezulton që një pjesë e kësaj sipërfaqeje të jetë blerë me vlerë tregu, por citohet çmimi sipas formularit të pagesës, sqaruar në paragrafin 23.1 më sipër.

23.6. Lidhur me koston e ndërtimit të kësaj pasurie (deklaruar 700.000 lekë në vitin 2003, ndërsa në *vetting* sipas vlerës së legalizimit), subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në Komision se ndërtimi i banesës është kryer me "argatë", nënkuptuar me krah pune falas, nga të afërmit e vet, përpara sesa ai të emërohej në funksionin e prokurorit dhe që e ka të pamundur të gjejë dokumente provuese, për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar dhe të informalitetit prezent asokohe në vend. Për mënyrën dhe kostot e ulëta të ndërtimit të banesës në {***}, si dhe për periudhën e transferimit aty, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur katër deklaratat noteriale, si dhe një vërtetim të Komunës {***} të datës 12.04.1996. Kolegji vëren se subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti asnjë dokumentacion justifikues për vlerën e ndërtimit të banesës, madje nuk saktëson as vitin kur është ndërtuar dhe as për koston nuk disponon asnjë dokument, pavarësisht se koha është e largët, nuk krijohet bindja se i gjithë ndërtimi është kryer me krah pune falas, "argatë". Sa u përket deklaratave noteriale, të gjithë deklaruesit pohojnë që kanë kontribuar në ndërtimin e banesës me punë vullnetare. Të gjitha deklaratat noteriale janë kryer gjatë procesit të rivlerësimit dhe megjithëse nuk janë të pavlefshme në kuptim të legjislacionit për noterinë, krijojnë bindjen se janë konceptuar në favor të deklaratimeve të subjektit të rivlerësimit, si rrjedhojë nuk mund të kenë efekt bindës në këtë proces (shih paragrafin 20.5 më sipër).

23.7. Lidhur me burimin e të ardhurave për ndërtimin e kësaj banese, Kolegji vëren se subjekti i rivlerësimit referon burime nga kursimet familjare të realizuara edhe nga emigracioni, në vitet 1993-1994, të cilat nuk ka mundur t'i provojë. Meqenëse nuk u paraqit asnjë dokument për të provuar këto të ardhura, pohuar edhe nga subjekti i rivlerësimit gjatë procesit administrativ, të gjitha të dhënat për burimet e të ardhurave për ndërtimin e banesës mbesin në nivel deklarativ të besueshëm, por nuk arrijnë të krijojnë bindjen për besueshmërinë e tyre në kuptim të nenit 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

23.8. Nga analiza e mësipërme, lidhur me pasurinë, “truall me sipërfaqe 633,8 m²”, Kolegji arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarime të ndryshme referuar deklarimeve në deklaratën *vetting* dhe në ato periodike e shpjegimeve gjatë procesit të rivlerësimit, sa i përket sipërfaqes së truallit dhe banesës mbi të, duke u përpjekur kështu të paraqesë në mënyrë të pasaktë këtë pasuri, duke i bërë të zbatueshme kërkesat e nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës në lidhje me parimin e prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit, përderisa ai nuk arriti të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit. Për pasojë, bazuar në nenin 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, kjo situatë ligjore dhe faktike, parë në vlerësimin tërësor, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, vlerësohet se çon në rezultatin se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut dhe ndodhet në kushtet e pamundësisë për plotësimin e mangësive nëpërmjet programit të trajnimit.

- 24.** Lidhur me shkakun e ankimit për pasurinë automjet tip “Mercedes Benz”, blerë nga subjekti i rivlerësimit Besnik Cani në vitin 2012, me kontratë shitblerjeje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 25.01.2012, prodhim i vitit 2006, me vlerë 1.300.000 lekë, Komisioneri Publik pretendoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar burimin e krijimit të pasurisë në DIPP-në e vitit 2012.

24.1. Kolegji vëren se në deklaratën *vetting* subjekti ka deklaruar autoveturë, tip “Mercedes Benz” me të dhënat e mjetit dhe me burim krijimi të ardhurat familjare në bashkëpronësi me bashkëshorten në pjesën 50%. Në DIPP-në e vitit 2012, deklarohet blerje autoveture më datë 25.01.2012, me vlerë 1.300.000 lekë, ku pjesa takuese e subjektit është 50%. Nga krahasimi i këtyre dy deklarimeve, rezulton se në DIPP-në e vitit 2012 nuk jepet i specifikuar burimi i krijimit të kësaj pasurie, ndërsa në deklaratën *vetting* rezulton i deklaruar nga subjekti i rivlerësimit burimi i krijimit të të ardhurave familjare.

24.2. Subjekti i rivlerësimit në parashtrimet e tij, në seancën publike në Kolegji, shpjegoi se mosdeklarimi i burimit të krijimit në vitin 2012 ka qenë thjesht një gabim i kuptueshëm njerëzor, si rezultat i pakujdesisë dhe nuk ka pasur si qëllim fshehjen.

24.3. Meqenëse ligji nr. 9049/2003, në nenin 4 të tij parashikon se: *Subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji detyrohen të deklarojnë në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe në inspektoratet e ulëta, brenda datës 31 mars të çdo viti, gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të pasurive, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare [...], për shkak të këtij detyrimi ligjor, subjekti duhej të deklaronte burimin e krijimit të kësaj pasurie në kohën kur e ka deklaruar për herë të parë në DIPP-në e vitit 2012.*

24.5. Kolegji arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka pasaktësi në deklarim lidhur me burimin e krijimit të pasurisë automjet tip “Mercedes Benz”, ndaj në këto rrethana, meqenëse është vetëm një deklarim i pasaktë në deklaratën periodike, vlerësohet se kjo pasaktësi e vetme nuk mund të ngrihet në nivelin e një shkaku shkarkimi. Por, kjo situatë ligjore dhe faktike, parë

në vlerësimin tërësor, në kuptim të nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, bën të aplikueshme kërkesat e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, në kuadrin e cenimit të besimit të publikut.

25. Lidhur me shkakun e ankimit për pasurinë “garazh”, me nr. pasurie {***}, datë 25.04.2012, sipërfaqe 18,7 m², në pallatin e shoqërisë “{***}” ShPK, rr. “{***}”, Tiranë, blerë me kontratën nr. {***} rep., nr. {***}kol., datë 10.04.2012, me vlerë 7000 euro, Komisioneri Publik pretendoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar burimin e krijimit të pasurisë në DIPP-në e vitit 2012.

25.1. Kolegji vëren se në deklaratën *vetting* subjekti ka deklaruar “garazh”, me të dhënat cituar në paragrafin më sipër dhe me burim krijimi të pasurisë të ardhurat familjare, por pa specifikuar pjesën takuese. Në deklaratën periodike të vitit 2012, deklarohet: Blerje garazhi me sipërfaqe 18,76 m², datë 10.04.2012, me vlerë 7000 euro, 100% në pronësinë e subjektit. Nuk deklarohet burimi i krijimit për këtë pasuri. Edhe nga krahasimi i këtyre dy deklarimeve rezulton se në deklaratën periodike të vitit 2012, nuk rezulton i specifikuar burimi i krijimit të kësaj pasurie, ndërsa në deklaratën *vetting* rezulton i deklaruar nga subjekti i rivlerësimit burimi i krijimit nga të ardhurat familjare.

25.2. Ashtu si në analizën e pasurisë më sipër, meqenëse ligji nr. 9049/2003, në nenin 4 të tij parashikon se: *Subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji detyrohen të deklarojnë në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe në inspektoratet e ulëta, brenda datës 31 mars të çdo viti, gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të pasurive, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare [...], për shkak të këtij detyrimi ligjor, subjekti duhej të deklaronte burimin e krijimit të kësaj pasurie në kohën kur e ka deklaruar për herë të parë, në DIPP-në e vitit 2012.*

25.3. Lidhur me pasurinë “garazh”, Kolegji arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka pasaktësi në deklarim lidhur me burimin e krijimit të saj, ndaj në këto rrethana, duke qenë se është pasaktësi e identifikuar në deklaratën periodike, ndërsa në deklaratën *vetting* është deklaruar burimi, vlerësohet se kjo pasaktësi e vetme nuk mund të ngrihet në nivelin e një shkakut shkarkimi, por kjo situatë ligjore dhe faktike, parë në vlerësimin tërësor, në kuptim të nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, bën të aplikueshme kërkesat e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, në kuadrin e cenimit të besimit të publikut.

26. Lidhur me shkakun e ankimit për analizën financiare e të ardhurave dhe shpenzimeve të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të për periudhën deri në vitin 2015, Komisioneri Publik pretendoi se subjekti i rivlerësimit nuk mbulon me të ardhura të ligjshme shpenzimet dhe investimet gjatë viteve 2010-2015, për një diferencë totale negative prej 2.152.963 lekësh.

26.1. Kolegji kreu analizën financiare për periudhën 2010-2015, nga e cila rezultoi se diferenca negative është të paktën sa ajo e konstatuar nga ankimi i Komisionerit Publik dhe Kolegji vlerëson se sipas kësaj analize financiare rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk mund të mbulonte shpenzimet e këtyre viteve me të ardhura të ligjshme, duke krijuar pasuri apo të ardhura më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht. Për pasojë, në kuptim të nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës, nenit 33, pika 5, shkronja “b” dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë.

27. Lidhur me shkakun e ankimit të Komisionerit Publik për kontratën me nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 27.01.2016, sipas së cilës subjekti i rivlerësimit ka dhënë me qira truallin e ndodhur në {***}, Tiranë, në favor të shoqërisë “{***}” ShPK, kontratë e cila edhe pse *de jure* është emërtuar si “kontratë qiraje”, *de facto*, për vetë elementet që ajo përmban, konsiston në një marrëdhënie tregtare, ku subjekti është pjesëmarrës në fitimin e shoqërisë për atë pjesë të kapitalit, sipas përcaktimeve në kontratë. Nga kjo marrëdhënie juridike, subjekti i rivlerësimit ka gjeneruar të ardhura, të cilat në vitin 2017 përbëjnë rreth 70% të të ardhurave të familjes së tij. Komisioneri Publik ka pretenduar se subjekti ndodhet në kushtet e mosarritjes së nivelit minimal kualifikues, referuar etikës dhe aftësive profesionale të tij. Si rrjedhojë, në konsideratë të qëllimit të nenit 179/b, pika 1 e Kushtetutës, kërkesave të nenit E të Aneksit të Kushtetutës, neneve 59, 61, pikat 4 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016 dhe për aq sa gjen zbatim ligji nr. 96/2016, mangësitë e konstatuara sjellin një përfundim të ndryshëm nga konfirmimi në detyrë i subjektit të rivlerësimit.

27.1. Kolegji vëren se subjekti i rivlerësimit ka lidhur një kontratë qiraje me shoqërinë {***} ShPK, ku qiradhënës është subjekti i rivlerësimit Besnik Cani dhe z. A. P. (përfaqësuar në këtë kontratë nga subjekti i rivlerësimit me anë të prokurës së posaçme nr. {***} rep., dhe {***} kol., datë 27.12.2015) dhe në rolin e qiramarrësit është shoqëria “{***}” ShPK. Objekti i kësaj kontrate është kalimi nga qiradhënësi te qiramarrësi i pasurive: (i) pasuria me nr. {***}, me sipërfaqe totale 633,8 m² truall dhe 112 m² banesë, e ndodhur në {***}, e cila është në pronësi të subjektit të rivlerësimit; (ii) pasuria me nr. {***}, me sipërfaqe truall 363,7 m² dhe ndërtesë 53,3 m², e ndodhur në {***}, në pronësi të z. A. P.. Këto pasuri do të përdoren nga qiramarrësi për ushtrimin e aktivitetit për tregtimin me pakicë të karburanteve dhe aktiviteteve tregtare ndihmëse, pasi qiramarrësi të ketë ndërtuar me shpenzimet e veta një stacion tregtimi me pakicë të karburanteve, lokal dhe lavazh. Kjo kontratë është lidhur me një afat kohor 25-vjeçar dhe parashikon përfundimin e saj më 27.01.2041.

27.2. Një element i rëndësishëm i kësaj kontrate është mënyra e pagesës së qirasë, e cila parashikon se qiradhënësit i takon 50% e fitimit bruto mbi 5 lekë të çdo litri karburant. Pagesa e qirasë do të bëhet pasi shoqëria “{***}” ShPK të zbresë nga vlera totale, tatimin në burim, sipas legjislacionit tatimor në fuqi, detyrim që i njihet qiradhënësit, si dhe 50% të fitimit neto mbi shumën mujore, që do të shërbejë për shlyerjen e investimit të kryer nga shoqëria “{***}” ShPK për ndërtimin e stacionit të tregtimit të karburantit, lokalit dhe lavazhit. Pagesa do të derdhet vetëm në numrin e llogarisë së subjektit të rivlerësimit. Në nenin 4.9 të kësaj kontrate, përcaktohet se palës qiradhënëse, në përfundim të shlyerjes së investimit të kryer nga qiramarrësi, shoqëria “{***}” ShPK i kalon pronësinë e stacionit të tregtimit me pakicë të karburanteve, së bashku me lokalin dhe lavazhin e ndërtuar, pasi të jetë vërtetuar që është shlyer investimi.

27.3. Për Kolegjin, nga pikëpamja juridike kjo kontratë nuk ka elementet tipike të kontratës së qirasë dhe, pavarësisht se është cilësuar nga palët si kontratë qiraje, ajo është një marrëveshje *sui generis*, e cila ka për shkak kryesor funksionin ekonomik-social. Kjo është një marrëdhënie atipike, me një shkak të përbërë ose miks, që ka elemente të kontratës së shkëmbimit, si dhe në të njëjtën kohë, mbart në vetvete edhe veçoritë e saj. Fakti që pagesa sipas marrëveshjes së palëve kalon çdo muaj, jo domosdoshmërisht e kanalizon marrëdhënien te kontrata e qirasë. Kjo marrëdhënie atipike krijohet si pasojë e kombinimit në një kontratë të vetme të shumë kontratave

tipike, duke kombinuar elemente të kontratës së sipërmarrjes (neni 850 i Kodit Civil), si dhe kontratës së shkëmbimit (neni 757 i Kodit Civil).

27.4. Rezulton nga dokumentet në dosje, se me kontratën e shitblerjes nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 25.10.2016, z. A. P. i shet subjektit të rivlerësimit pasurinë të cilën ia ka dhënë me qira shoqërisë {***} ShPK, ku tashmë subjekti i rivlerësimit bëhet pronar i vetëm i truallit prej 997,5 m². Më datë 06.01.2017, subjekti i rivlerësimit nënshkruan me shoqërinë “{***}” ShPK amendamentin e kontratës së qirasë me nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., sipas së cilës pagesa e qirasë do të përlllogaritet duke nisur nga data 03.12.2016.

Nga tërësia e veprimeve të analizuar dhe mënyra e likuidimit të qiradhënësit nga qiramarrësi, subjekti i rivlerësimit nuk duket thjesht si qiradhënës, ku në këtë rast përveç truallit të vënë në dispozicion qiramarrësit, ka investuar edhe banesën prej 112 m² (të shembur nga shoqëria “{***}” ShPK), në këmbim të fitimeve të rëna dakord, sipas kontratave të nënshkruara (kontrata e qirasë + amendamenti i kontratës).

27.5. Kolegji vëren gjithashtu se më datë 01.04.2017, qiramarrësi, shoqëria “{***}” ShPK, një vit pas lidhjes së kontratës së qirasë, heq dorë nga e drejta e përdorimit dhe fitimit nga lavazhi dhe lokali bar-kafe, duke ia kaluar këtë të drejtë subjektit të rivlerësimit. Po në të njëjtën datë me akt-marrëveshjen nr. {***} rep., nr. {***} kol., subjekti i rivlerësimit ia kalon të drejtën e përdorimit për ambientet lavazh dhe lokal bar-bufe, djalit të tij, z. E. C.. Ky i fundit, me anë të prokurës nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 29.06.2017, ia delegon të drejtën e përfaqësimit të administrimit të këtij aktiviteti tregtar (lavazh dhe lokal bar-bufe), nënës së tij, znj. L. C..

Subjekti i rivlerësimit gjatë gjykimit të çështjes në Kolegji nuk arriti të shpjegojë bindshëm ekzistencën e një marrëdhënieje të pastër qiraje me shoqërinë. Komisioni ka vlerësuar se marrëdhënia kontraktuale ekzistuese midis subjektit dhe shoqërisë “{***}” ShPK, që i ka mundësuar atij krijimin e një përfitimi “qiraje” të ndryshëm dhe të përcaktueshëm, muaj pas muaji, në përpjesëtim me xhiron e biznesit të kompanisë, përfshirë këtu edhe mënyrën e përfitimit dhe të administrimit të lokalit bar-kafe dhe të lavazhit, ka prodhuar dhe po prodhon efekte të përfitimeve financiare të ndërthurura brenda familjes së subjektit të rivlerësimit, çka krijon bindjen mbi një përfitim nga pozicioni profesional i z. Besnik Cani. Kolegji ndryshe nga Komisioni, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 në lidhje me nenin 61, pika 5 e të njëjtë ligj, këto vlerësime në lidhje me veprimet dhe mosveprimet e subjektit të rivlerësimit në raport me shoqërinë “{***}” ShPK, i çmon të atilla që duhet të krijojnë te publiku perceptimin se subjekti i rivlerësimit Besnik Cani nuk mund të jetë i pavarur në përmbushjen e funksionit të magjistratit.

- 28.** Lidhur me shkakun e ankimit të Komisionerit Publik, se qëndrimi i Komisionit është kontradiktor dhe jobindës, nisur nga krahasimi i marrëdhënies kontraktuale mes subjektit të rivlerësimit nga njëra anë dhe marrëdhënies së shoqërisë “{***}” ShPK me qiradhënës të tjerë nga ana tjetër, Komisioneri Publik u është referuar kontratave të administruara në cilësinë e provës, të pretenduara të ngjashme nga Komisioni. Komisioneri Publik pretendoi se aspekti financiar është tipari dallues kryesor i kësaj marrëdhënieje juridiko-civile, por elementi që është më i rëndësishëm, që duhet të gjejë adresim në lidhje me procesin e rivlerësimit të subjektit, është vlerësimi i saj në raport me detyrimet etike të subjektit të rivlerësimit, si detyrime ligjore të tij, dhe analizimi nëse jemi përballë cenimit të tyre. Nga kjo situatë faktike, Komisioneri Publik pretendoi se ka elemente të mjaftueshme për të konkluduar se kjo marrëdhënie kontraktuale e

subjektit të rivlerësimit bie ndesh me detyrimet ligjore etike të tij, të tilla që mjaftojnë për t'u interpretuar si fakte papajtueshmërie në ushtrimin e funksionit të prokurorit në rastin konkret.

28.1. Lidhur me shkakun e mësipërm të ankimit, Kolegji vëren se duke vlerësuar elementet e kontratës së lidhur nga subjekti i rivlerësimit me shoqërinë “{***}” ShPK, duket qartë që kjo kontratë nuk gëzon elementet tipike të kontratës së qirasë, në kuptim të nenit⁸ 801 të Kodit Civil, ku në kontratë, shpërblimi është i caktuar për objektin e marrë me qira në gëzim të përkohshëm, ndërsa në rastin konkret subjekti i rivlerësimit, sipas kontratës së lidhur me këtë shoqëri, ka një shpërblim progresiv ose regresiv, në varësi të ecurisë së biznesit të pikës së karburantit, ku në përfitimin 5 lekë për litër bruto, subjekti i rivlerësimit merr 50% të fitimit neto mbi përfitimet mujore të shoqërisë (i kalonte në llogari më datë 10 të çdo muaji), ndërsa pjesa e mbetur prej 50% do të shërbejë për kompensimin e investitorit, shoqërisë “{***}” ShPK, për ndërtimin e stacionit të tregtimit të karburantit, lokalit dhe lavazhit. Më tej, duhet vënë theksi edhe te pjesa e kontratës (neni 4.9), ku në përfundim të afatit të qirasë, stacioni i karburantit së bashku me lokalin dhe lavazhin në gjendje pune do t'i kalojnë subjektit të rivlerësimit, pasi të jetë vërtetuar shlyerja e investimeve të shoqërisë “{***}” ShPK. Nga kjo marrëdhënie e quajtur qiraje, fitimi i subjektit të rivlerësimit shkon përtej një kontraktimi të thjeshtë qiraje, pasi ai hyn në një terren risku rritës ose zbritës të fitimeve të kompanisë dhe ky rregullim i palëve nuk krijon bindjen që kjo marrëdhënie juridike ndërmjet palëve është një kontratë qiraje.

28.2. Në seancën e datës 11.02.2020, avokati i subjektit të rivlerësimit u shpreh saktësisht: *Në asnjë vend tjetër, dhe e sfidoj Komisionerin nëse gjen një kontratë të vetme që nuk cilësohet si kontratë qiraje, por cilësohet si kontratë ndryshe, pra ku ta di unë, si ta cilësojë ai, në dashtë kontratë ndërtimi, në dashtë kontratë koncesioni. Cilësohet në të gjitha vendet si kontratë qiraje dhe unë cilësova këtu herën e kaluar siç, të mos e përsëris, edhe standardi edhe kontratat të cilat janë, i përdor B. P., gjiganti, dhe i përdor pikërisht me shitjen me çmim variabël, pra kjo është, po flas tani, sigurisht nuk pretendoj që as klienti të ketë pasur këtë lloj përgatitje në momentin kur dokumentet standarde janë përgatitur nga kompania dhe të jenë përcjellë atje formularë dhe të jenë nënshkruar dhe të jenë parë se si e ka B. P., siç ua shpjegova unë që nga Singapori, si e kanë në Itali, por pjesa ime për sa u përket njohurive që kam në këtë fushë, dhe Komisioneri dhe sot nuk citoi as edhe një nen të vetëm me të cilin bie ndesh veprimtaria e prokurorit në momentin që është lidhur kjo kontratë qiraje me shoqërinë “{***}”, asnjë nen dhe do ta mbyll këtë përshkrim, këtë parashtrim me logjikë të arsyeshme dhe me një analizë racionale.*

28.3. Kolegji vëren se shoqëria “{***}” ShPK, me shkresën nr. {***} prot., datë 23.08.2018, në përgjigje të shkresës së Komisionit për kërkesë informacioni me nr. {***} prot., datë 10.08.2018, solli disa kontrata të tjera të ngjashme qiraje për krahasimin e marrëdhënies kontraktuale me subjektin nga njëra anë me marrëdhëniet e shoqërisë “{***}” ShPK me subjekte të tjera, referuar kontratave të ngjashme të administruara në cilësinë e provës. Konstatohet se elementet kontraktuale në secilën prej tyre (kontratave) paraqiten të ndryshme në efektet ligjore që passjellin. Në analizë të përmbajtjes së këtyre kontratave, konstatohet se ato janë kontrata tipike qiraje në kuptim të nenit 801 të Kodit Civil dhe vetëm njëra prej tyre, kontrata e datës 16.03.2017, me nr. {***} rep. dhe nr. {***} kol., ka titullin “kontratë bashkëpunimi” dhe është një kontratë e ngjashme me kontratën që shoqëria “{***}” ShPK ka lidhur me subjektin. Megjithatë, edhe në këtë rast, kontrata e ofruar për referencë ka ndryshime të dukshme lidhur me

⁸Qiraja është kontrata me të cilën njëra palë (qiradhënësi) detyrohet t'i japë palës tjetër (qiramarrësit) një send të caktuar, në gëzim të përkohshëm, kundrejt një shpërblimi të caktuar.

investimin, i cili sipas kontratës me subjektin, i mbetet këtij të fundit, ndërsa në kontratën e ngjashme, investimi i mbetet shoqërisë “{***}” ShPK. Në rastin konkret, në fund të kohëzgjatjes së kontratës me subjektin e rivlerësimit, subjekti do të bëhet pronar mbi objektet e ndërtuara në tokën e tij, ndërkohë që ky fakt nuk parashikohet në kontratën e ofruar për referencë.

28.4. Nga aktiviteti privat lavazh/bar–kafe, djali i subjektit, z. E. C., ka përfituar 1496.173 lekë. Të ardhurat e përfituara nga qiraja me shoqërinë “{***}” ShPK për vitin 2017, janë në shumën 2888.769,2 lekë, nga të cilat 50% janë arkëtuar nga subjekti (në llogarinë bankare të tij) dhe 50% kanë shkuar për shlyerje investimi, pronësinë e të cilit subjekti do ta fitojë pas kalimit të afatit prej 25 vjetësh. Në total, përfitimet financiare për vitin 2017 nga kjo marrëdhënie juridiko-civile, arrijnë në shumën 4384942 lekë, duke zënë rreth 70% të totalit të të ardhurave të familjes së subjektit për vitin 2017. Nga ana tjetër, përveç të ardhurave të gjeneruara si më sipër cituar, në amendamentin nr. 2 të kontratës së qirasë, datë 01.04.2017, nr. {***} rep., dhe {***} kol., qiramarrësi, shoqëria “{***}” ShPK, heq dorë nga e drejta 25-vjeçare për përdorimin e lokalit bar-kafe dhe lavazh, për ushtrimin e aktivitetit tregtar të parashikuar për t’u kryer në këto ambiente, duke parashikuar kalimin e kësaj të drejte te subjekti i rivlerësimit, pa asnjë kundërvlerë financiare, është veprim i cili të krijon dyshime për të qenë një kusht i kontratës së qirasë.

28.5. Duke iu referuar elementeve të marrëdhënies juridike, në analizën më sipër, të cilët janë pjesë e kontratës që subjekti i rivlerësimit ka lidhur me shoqërinë “{***}” ShPK, rezulton se kjo marrëdhënie gjeneron të ardhura variabël në varësi të xhirimeve të shoqërisë: kalimi 50% të fitimeve neto të 5 lekëve për litër në llogarinë e subjektit të rivlerësimit, aktiviteti bar/lavazh i djalit të subjektit të rivlerësimit, si dhe kalimi i asetëve të shoqërisë pas 25 viteve në pronësi të subjektit të rivlerësimit, janë të gjitha elemente që nuk përbëjnë kurrsesi elementet e një kontrate qiraje, sipas përcaktimeve ligjore që i përkasin kësaj kontrate.

28.6. Gjithashtu neni 4, pika 2, germa “b” e ligjit nr. 96/2016, përcakton se: *Magjistrati merr të gjitha masat për të mbrojtur dhe forcuar reputacionin e organeve të drejtësisë dhe besimin e publikut në sistemin gjyqësor dhe atë të prokurorisë.* Para hyrjes në fuqi të ligjit nr. 96/2016, papajtueshmëritë me detyrën e prokurorit kanë gjetur rregullim edhe në urdhrin nr. 141, datë 19.06.2014, të Prokurorit të Përgjithshëm “Për miratimin e rregullave mbi etikën dhe sjelljen e prokurorëve”. Sipas nenit 4, pika 1, germa “ç” e këtij urdhri parashikohet: *Prokurorët në ushtrimin me pavarësi të funksioneve apo detyrave të tyre, duhet që të mos zhvillojnë veprimtari ekonomike, përfshirë çdo lloj pune apo biznesi për të përfituar interesa materiale ose jomateriale, që mund të ndikojnë në pavarësinë e tyre, ose që mund të krijojnë përshtypjen e përdorimit të detyrës për interesat e tyre ose personave të tjerë [...].* Sipas këtij parashikimi, zhvillimi i veprimtarisë ekonomike, i çdo lloj pune apo biznesi me qëllim përfitimin e të mirave materiale ose jomateriale, duhet të jetë i tillë që të mos sjellë ndikime në pavarësinë e ushtrimit të funksioneve apo detyrave të prokurorëve, në drejtim të përdorimit të detyrës për interesa privatë. Në çështjen konkrete, subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut, pasi ai është ekspozuar në një marrëdhënie ku përfitimet materiale të tij, të cilat buronin nga kontrata me shoqërinë, janë tërësisht të varura në vullnetin dhe dëshirën e shoqërisë, lidhur me volumin e aktivitetit që do të zhvillohet pranë kësaj pike karburanti. Pra, ekspozimi i subjektit të rivlerësimit në një lloj marrëdhënieje të tillë me shoqërinë tregtare, e ka bërë atë një subjekt që mund të ndikohet për shkak të nevojës së tij për garantimin e përfitimeve materiale nga kjo kontratë, në një subjekt që mund të ndikohet në ushtrimin e detyrës në mënyrë të pavarur.

28.7. Kolegji vëren gjithashtu se në përgjigje të shkresës me nr. {***} prot., datë 10.08.2018, të Komisionit, dërguar shoqërisë “{***}” ShPK për kërkesë informacioni në lidhje me këtë marrëdhënie, kjo e fundit (shoqëria) ka kthyer përgjigjen me nr. {***} prot., datë 23.08.2018, ku ndër të tjera ka sqaruar në paragrafin 1.2.4 të kësaj shkrese se: *Në politikat tona të kompanisë, ne nxisim partnerët tanë në biznes që të marrin përsipër edhe ata risqe. Ne duam të përfitojmë nga marrja përsipër e këtyre risqeve, si dhe nga detyrimi i tyre që të tregtojnë vetëm produktet tona, sipas çmimeve të diktuara prej nesh dhe duke i detyruar ata të reklamojnë vetëm produktet tona, pa asnjë rimbursim për këto reklama. Emri ynë dhe pozicioni ynë dominues në treg na jep të drejtën që të vendosim kushte të tilla të favorshme për kompaninë. Pa dyshim, që kjo e vendos kompaninë në një pozicion preferencial karshi tyre. Bashkëngjitur kësaj shkrese, shoqëria “{***}” ShPK ka dërguar pesë kontrata noteriale për krahasim, pasqyrat financiare në lidhje me përlogaritjen e fitimit për periudhën dhjetor 2016 - korrik 2017, si dhe njoftim debitimi datë 05.07.2018, të Bankës Raiffeisen, sipas të cilit është urdhëruar likuidimi i muajit qershor nga shoqëria te subjekti i rivlerësimit. Pra, vetë shoqëria “{***}” ShPK, duke iu referuar kontratave të lidhura, i konsideron personat me të cilët ka kontraktuar, partnerë në biznes, të cilët marrin përsipër risqe në ecurinë e biznesit, marrëdhënie e cila shkon përtej kushteve të kontratës së qirasë.*

28.8. Kolegji, në analizën e tij, arsyeton se subjekti i rivlerësimit ka ndërtuar një marrëdhënie biznesi ku normën e fitimit të tij e ka lënë plotësisht në vullnetin dhe dëshirën e shoqërisë “{***}” ShPK. Vetëm kjo e fundit ka të drejtë të vendosë për sasinë e karburanteve që do të shesë, mund të ndërpresë shitjen në periudha të caktuara kohore ose t’i mbajë shitjet në nivele minimale ose maksimale sipas dëshirës, pa pasur asnjë përgjegjësi ndaj subjektit për uljen ose rritjen e normës së fitimit të tij. Në këto situata, subjekti i rivlerësimit e ka ekspozuar veten ndaj rrezikut që pala tjetër t’i imponojë një fitim më të madh ose më të vogël, në varësi vetëm të dëshirës së saj dhe ky mekanizëm e ekspozon hapur subjektin ndaj rrezikut që ai të bjerë nën ndikimin e palës tjetër edhe për mënyrën e përmbushjes së detyrave të tij publike.

Kolegji vlerëson se marrëdhënia kontraktuale ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe shoqërisë “{***}” ShPK ka prodhuar një mospërputhje thelbësore me funksionin e prokurorit dhe detyrimet në lidhje me etikën. Kolegji beson se sipas perceptimit të arsyeshëm, me mendje të shëndoshë dhe të informuar të anëtarëve të një komuniteti, një kontratë e tillë do të zbehte respektin për një magjistrat dhe/ose gjyqësorin në tërësi.

28.9. Kolegji arrin në përfundimin, në lidhje me marrëdhënien kontraktuale të subjektit të rivlerësimit me shoqërinë tregtare “{***}” ShPK, në kuptim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, se nga rrethanat e kësaj marrëdhënieje, duke gjeneruar dhe shpërndarë të ardhura të ngjashme me një shoqëri tregtare⁹, konsiderohen si fakte të çështjes që janë të mjaftueshme për të arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Besnik Cani nuk mund të gëzojë besimin e publikut për të qëndruar në detyrë dhe ndodhet në kushtet e pamundësisë për plotësimin e mangësive nëpërmjet programit të trajnimit.

29. Lidhur me shkakun e ankimit për përfitimin nga programet sociale për strehim, ku figuron si përfituese edhe bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, Komisioneri Publik pretendoi se jemi

⁹ Neni 1074 i Kodit Civil, “Shoqëria e thjeshtë”: “Shoqëria është një kontratë me të cilën dy apo më shumë persona merren vesh për të ushtruar një aktivitet ekonomik, me qëllim që të ndajnë fitimet që rrjedhin prej tij. Personi anëtar i shoqërisë duhet të vërë në dispozicion të këtij aktiviteti para, sende apo shërbime”.

përballë shkeljes së etikës së magjistratit dhe rrethanave të përfitimit të padrejtë dhe jashtë kriterëve ligjore për shkak funksioni. Elementi i rëndësishëm në analizimin e përmbushjes së standardit të etikës nga ana e subjektit, në rastin konkret është vlerësimi tërësor i fakteve dhe provave të administruara, që nëpërmjet kalimit të barrës së provës, organi rivlerësues të tejkalojë çdo dyshim të arsyeshëm nëse subjekti me veprimet apo mosveprimet e tij ka cenuar rregullat etike profesionale, figurën e magjistratit e, për rrjedhojë, besimin e publikut, referuar nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Komisioneri Publik pretendoi se përfitimi jashtë kriterëve ligjore nga programet sociale për strehim të subjektit në qytetin e Fierit, ndërkohë që ky i fundit ushtronte funksionin e drejtuesit të prokurorisë në këtë qytet, që po hetonte funksionarët shtetërorë për shpërdorim detyre dhe falsifikim dokumentesh në trajtimin e familjeve me kredi të lehtësuara, është rrjedhojë e përfitimit të padrejtë për shkak funksioni dhe bie ndesh me përmbushjen e standardeve të etikës profesionale.

29.1. Kolegji vëren se gjatë periudhës nga 01.04.2010 deri më 03.04.2013, subjekti i rivlerësimit ka qenë drejtues i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier. Më datë 28.03.2013, Këshilli i Bashkisë Fier, me vendimin nr. 14, ka miratuar listën emërore me personat, familjet e të cilëve do të përfitonin nga programi social i kredisë së lehtësuar nga shteti, për blerjen e banesave me kosto të ulët, ku pjesë e listës figuron të jetë edhe bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, znj. L. Gj. C..

29.2. Mbi bazën e kallëzimit të disa qytetarëve të rrethit Fier, për paligjshmëri në ushtrimin e detyrës nga funksionarë të Bashkisë Fier, gjatë akordimit të kredive të lehtësuara për familjet që do përfitonin nga programet sociale për strehim, në fillim të muajit korrik 2012 është regjistruar procedimi penal që mban nr. {***}. Me vendimin e datës 30.07.2012, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier ka vendosur mosfillimin e procedimit penal. Vendimi i mosfillimit i kalon për miratim subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier, i cili e miraton këtë vendim dhe ua komunikon kallëzuesve me anë të shkresës së datës 04.09.2012. Kallëzuesit, duke mos qenë dakord me vendimin e mosfillimit të procedimit penal, e ankimojnë atë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier dhe kjo e fundit, më datë 06.02.2013, prish vendimin e Prokurorisë Fier dhe urdhëron kryerjen e veprimeve të nevojshme hetimore.

29.3. Më datë 31.10.2012, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal nr. {***}, për veprën penale “Shpërdorim i detyrës”, kryer në bashkëpunim dhe veprën penale të “Falsifikimit të dokumenteve”.

Pas shpalljes së vendimit të mësipërm të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, më datë 26.03.2013, nga ana e drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier (subjekti i rivlerësimit), është marrë vendimi për bashkimin e procedimeve nr. {***}, datë 20.03.2013 dhe atij nr. {***}, datë 31.10.2012. Gjatë kësaj kohe, kallëzuesit i janë drejtuar sërish Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier me kërkesë-padi, duke kërkuar ndryshimin e vendimit të Këshillit të Bashkisë Fier nr. {***}, kërkim mbi të cilin gjykata me vendimin nr. {***}, datë 11.03.2013, ka vendosur pranimin e padisë, duke disponuar pavlefshmërinë e aktit administrativ të Këshillit Bashkiak Fier dhe detyrimin e këtij të fundit për rinxjerrjen e aktit administrativ. Siç vërehet më sipër, gjatë ecurisë së veprimeve hetimore si dhe ndjekjes gjyqësive të çështjes nga ana e qytetarëve, rezulton që subjekti i rivlerësimit ka qenë me detyrë drejtues i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier.

29.4. Subjekti i rivlerësimit, i pyetur nga Komisioni në lidhje me këto rrethana, ka sqaruar në shpjegimet e datës 20.11.2018 se nuk ka qenë qëllimi apo dëshira e tij të përfitonte një trajtim të pamerituar me kredi të butë, dhe nëse ai do të kishte pasur këtë lloj qasjeje, mund të kishte

tentuar apo ta kishte përfituar atë në qytetet e tjera, Shkodër dhe Elbasan, ku ai kishte pasur funksionin e drejtuesit të prokurorive të këtyre rretheve.

Fakti që subjekti i rivlerësimit nuk ka kërkuar të përfitonte në qytetet Shkodër dhe Elbasan, nuk përjashton mundësinë dhe dëshirën për të përfituar në qytetin e Fierit, ndaj mundësia për të përfituar është e provuar me listën e shpallur më datë 28.03.2013, nëpërmjet vendimit nr. {***} të Këshillit të Bashkisë Fier, ku bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit është e listuar si përfituese.

29.5. Kolegji vëren se subjekti është kontradiktor me shpjegimet e tij pas kalimit të barrës së provës, paraqitur në Komision më datë 08.11.2018, teksa shprehet se kërkesa e bashkëshortes së tij, e cila me profesion është mjekë dhe për rrjedhojë nuk ka dijeni mbi legjislacionin [...] ishte kushtëzuar nga nevoja për të qenë më i pranishëm në familje, mundësia e pakët e transferimit në Tiranë, mungesa e likuiditeteve të nevojshme për të bërë të mundur blerjen e një banese në Fier, të cilat vijnë në kontradiktë me pretendimin e subjektit mbi mosdijeninë e tij për aplikimin për kredi nga ana e bashkëshortes së tij apo mospasjes së njohurive të duhura ligjore. Në parashtrimet e paraqitura në seancë publike në Kolegji, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se: *pasi kam marrë dijeni për këtë gjë, kam kërkuar nga bashkëshortja ime tërheqjen nga kjo procedurë dhe e vërteta është se ne nuk e kemi përfituar asnjëherë këtë kredi.*

29.6. Sipas legjislacionit që rregullon rastet e përfitimit të kredive të lehtësuara, neni 4 i ligjit nr. 9232, datë 13.05.2004, “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”, i ndryshuar, përfitojnë strehim (i) individët, që kanë mbushur moshën 18 vjeç dhe (ii) familjet e regjistruara në zyrat e gjendjes civile në njësitë e qeverisjes vendore, të cilat, në momentin e aplikimit, plotësojnë kushtet e mëposhtme:

a) nuk kanë në pronësi një banesë; b) zotërojnë sipërfaqe banimi nën normat e strehimit, të përcaktuara për atë kategori sociale dhe ekonomike, ku bëjnë pjesë këto familje, ose banojnë në banesa jashtë standardeve në fuqi; c) kanë mbetur të pastrehë, si rezultat i fatkeqësive natyrore. Përfshihen në njërin nga shkronjat “a”, “b” dhe “c” të pikës 1 të këtij neni vetëm ato familje, që kanë të ardhura të pamjaftueshme.

Në lidhje me germën “a”, subjekti i rivlerësimit nuk është para këtij rasti, pasi në vitin 2013 kishte në pronësi truall + banesë në {***}, si dhe apartament dhe garazh në rr. “{***}”, Tiranë. Sa i përket kategorizimit të germës “b” më sipër, për familjet që banojnë në banesa jashtë standardeve në fuqi, në rastin konkret nuk rezulton të ketë qenë në këto kushte subjekti i rivlerësimit.

Lidhur me përfshirjen në një nga pikat më sipër vetëm ato familje që kanë të ardhura të pamjaftueshme, subjekti nuk bën pjesë, pasi të ardhurat familjare të tij kanë qenë të larta.

29.7. Kolegji, duke iu referuar të dhënave më sipër, si situata e përfitimit të kredisë së lehtësuar ka marrë shkas nga disa fakte reale, ndër të cilat edhe marrja e statusit të pastrehë në një moment të caktuar dhe pa përmbushur kriteret ligjore, vlerëson se nga ana e subjektit të rivlerësimit duhej evituar kjo situatë pa filluar përfshirja e bashkëshortes së tij në mënyrë të padrejtë në listën e familjarëve të pastrehë të Këshillit Bashkiak Fier. Kjo situatë faktike kompleksohet me faktin tjetër që subjekti i rivlerësimit në të njëjtën kohë po hetonte funksionarët publikë për shpërdorim detyre dhe falsifikim dokumentesh në trajtimin e familjeve me kredi të lehtësuar në qytetin e Fierit.

29.8. Kolegji, në analizë të fakteve të mësipërme, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit si përfitues jashtë kriterëve ligjore të statusit të pastrehë të familjes së tij në qytetin e Fierit, në të

njëjtën kohë që ushtronte funksionin e drejtuesit të prokurorisë në këtë qytet, ka ardhur si pasojë e përfitimit të padrejtë për shkak funksioni dhe bie ndesh me përmbushjen e standardeve të etikës profesionale. Mund të përmendim këtu një ndër Parimet e Bangalores për sjelljen e gjyqtarit që mund të aplikohet, *mutandis mutandis*, për prokurorët, pikën 4.9 që parashikon: “Një gjyqtar nuk duhet të përdorë apo të cenojë prestigjin e postit të gjyqtarit për interesa private të tij apo të një anëtarit të familjes së tij, apo të kujtdo tjetër, dhe as nuk duhet të krijojë përshtypjen apo të lejojë të tjerët të krijojnë përshtypjen se kushdo me pozitë të veçantë ndikon padrejtësisht në punën e tij gjatë ushtrimit të profesionit”. Situata ligjore dhe faktike kjo, parë në vlerësimin tërësor, në zbatim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, dhe në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, që çon në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut dhe ndodhet në kushtet e pamundësisë për plotësimin e mangësive nëpërmjet programit të trajnimit.

30. Lidhur me shkakun e ankimit për procedimin penal nr. {***}, të vitit 2006, regjistruar pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Komisioneri Publik pretendoi se konkluzioni i Komisionit për këtë çështje nuk u përgjigjet rrethanave të faktit konkret dhe është rezultat i zbatimit të gabuar të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016. Komisioneri Publik pretendon se mbetet e paqartë metodologjia e përdorur nga Komisioni në arritjen e përfundimit se subjekti [...] *arrin më së paku nivelin minimal kualifikues*, kur ndërkohë Komisioni ka konstatuar se subjekti shfaq modele të njëjta pune, të përsëritura, me problematika të ngjashme dhe për dy raste të tjera të denoncuar. Në vlerësimin e Komisionerit Publik, nëse gjetjet dhe mangësitë e konstatuara do t'i nënshtroheshin vlerësimit sipas këtij kuadri rregullator, subjekti rezulton me mangësi të njëjta, të përsëritura për të paktën (i) aftësitë profesionale; (ii) aftësitë organizative dhe (iii) arsyetimin ligjor, shkaqe këto të cilat në vlerësimin e Komisionerit Publik çojnë në zbatimin e nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

30.1. Kolegji vëren se Komisioni ka kërkuar dhe administruar dosjen hetimore të procedimit penal nr. {***}, të vitit 2009, që lidhej edhe me procedimin e mësipërm dhe me kallëzimin penal nr. {***}, nga studimi dhe analizimi i të cilave rezultoi se shtetasi V. Ç. ka kallëzuar për veprën penale të “Falsifikimit” në bashkëpunim, shtetasit F. dhe T. Ll.

Në datën 22.11.2007, është marrë vendim “Për mosfillimin e procedimit penal me nr. {***}”, nga subjekti i rivlerësimit Besnik Cani, si dhe nga zv/prokurori i rrethit Tiranë, Sh. K.. Lidhur me këtë vendim, është arsyetuar se procedimi penal nuk mund të fillohet, pasi nuk konstatohet element i ndonjë veprë penale. Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë¹⁰, gjatë shqyrtimit të kësaj çështjeje nuk ka konstatuar ndonjë akt të falsifikuar, që në bazë të neneve 271 dhe 272 të K.P.C., do të sillte me të drejtë pezullimin e gjykimit deri në përfundimin e çështjes penale.

30.2. Kallëzuesi V. Ç. e ka ankimuar këtë vendim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me objekt prishjen e vendimit “Për mosfillimin e procedimit penal {***}” të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe urdhërimin e vazhdimin të hetimeve. Kjo gjykatë, me vendimin e saj nr. {***}, datë 07.10.2008, ka vendosur pranimin e kërkesës së qytetarit V. Ç. kundër vendimit të

¹⁰ *Vëllezërit Ll. kanë paditur në gjykatë ish-AKP dhe kallëzuesin V. Ç., me objekt padie “konstatimin e pavlefshmërisë absolute të kontratave të shitblerjes”, nëpërmjet të cilave kallëzuesi i mësipërm ka blerë magazinë dhe truall në Rrugën e Kavajës, Tiranë. Gjykata, pasi ka shqyrtuar çështjen, me vendimin nr. {***}, datë 27.09.2006, ka vendosur pranimin e padisë, duke konstatuar pavlefshmërinë absolute të kontratave të shitblerjes ndërmjet V. Ç. dhe AKP-së dhe kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme.*

prokurorisë për mosfillimin e procedimit penal¹¹, si dhe vazhdimin e hetimeve të mëtejshme lidhur me këtë procedim.

30.3. Në shpjegimet që ka dhënë subjekti i rivlerësimit, lidhur me këtë çështje, pas kalimit të barrës së provës në Komision, si dhe në parashtrimet e dorëzuara në seancën publike të datës 20.01.2020 në Kolegj, ka shpjeguar se çështja duhet parë në kontekstin e vitit 1995, kohë kur ka hyrë në fuqi Kodi i Procedurës Penale dhe ka pasur qasje të ndryshme lidhur me momentin e regjistrimit të procedimit penal dhe me funksionimin e organit të prokurorisë. Gjithashtu, subjekti shpjegon se kishte një dyndje kallëzimesh të cilat krijojnë mbingarkesë dhe vështirësi hetimore, pasi bëhej fjalë për dokumente të prodhuara në kohën e mungesës së autoritetit të shtetit. Është synuar të vendoset si standard që nuk mund të regjistrohej një procedim penal nëse nuk kishte një provë shoqëruese si akti i ekspertimit grafik.

30.4. Më datë 30.12.2009, subjekti i rivlerësimit Besnik Cani, pas veprimeve hetimore në lidhje me procedimin penal nr. {***} të vitit 2009, ka vendosur dërgimin e çështjes në gjyq, duke konstatuar se nga tërësia e akteve të çështjes penale janë kryer të gjitha veprimet hetimore dhe janë mbledhur provat që vërtetojnë fajësinë e të pandehurve për veprën penale të “Falsifikimit të dokumentit”, e kryer në bashkëpunim, e parashikuar nga neni 186/2 i Kodit Penal. Edhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në përfundim të gjykimit, me vendimin nr. {***}, datë 01.04.2011, ka vendosur: “Deklarimin fajtor të të pandehurve F. dhe T. Ll. për kryerjen e veprës penale të “falsifikimit të dokumenteve”, në bashkëpunim, “Falsifikimi i dokumenteve në bashkëpunim në formën e përdorimit” dhe dënimin e secilit prej tyre me nga 6 muaj burgim dhe 300.000 lekë gjobë”.

30.5. Referuar rrethanave të mësipërme, Kolegji vëren se subjekti i rivlerësimit ka hetuar vetë çështjen, për të cilën më parë ka dhënë vendim mosfillimi të procedimit penal, i cili pas veprimeve hetimore ka rezultuar se ekzistojnë elemente të veprës penale. Subjekti i rivlerësimit nuk ka vlerësuar provat e paraqitura nga kallëzuesi V. Ç., siç janë dy vendimet e AKP-së, që janë të njëjta në numër dhe datë, por me ndryshim në përmbajtje. Megjithëse këto vendime ishin në dosjen e procedimit penal, nuk u morën parasysh nga subjekti i rivlerësimit që ishte prokuror i çështjes, për të cilën ka konstatuar se nuk ekzistojnë elemente të veprës penale. Mospërputhja e këtyre dy dokumenteve ishte lehtësisht e verifikueshme për të mos vendosur mosfillimin e procedimit penal, për të cilat u caktua edhe një ekspert gjatë hetimeve, i cili konstatoi faktin e falsifikimit. Prokurori ka detyrim të kryejë veprime hetimore, të ushtrojë ndjekje penale, të drejtojë dhe kontrollojë hetimet paraprake, si dhe të kryejë vetë çdo veprim hetimor që e çmon të nevojshëm sipas rregullave të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale. Gjithashtu, nuk mund të pretendohet nga ana e subjektit të rivlerësimit se funksionimi i organit të prokurorisë ka pasur qasje të ndryshme në vitin 1995, ndërkohë që procedimi penal për të cilin është vendosur mosfillimi i përket vitit 2006.

30.6. Si rezultat i analizës më sipër, Kolegji arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit i kishte të gjitha rrethanat ligjore dhe provat për të vazhduar veprimet hetimore lidhur me procedimin penal, për të cilin subjekti i rivlerësimit ka vendosur mosfillimin.

¹¹ Vetë subjekti i rivlerësimit Besnik Cani, i thirrur në këtë proces gjyqësor si përfaqësues i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka kërkuar pranimin e kërkesës nga gjykata dhe vazhdimin e hetimeve për procedimin penal {***}.

31. Lidhur me shkakun e ankimit për procedimin penal nr. {***} të vitit 2015, regjistruar pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan, Komisioneri Publik pretendoi se konstatohen mangësi profesionale në kryerjen e hetimeve të thelluara, cilësim korrekt i veprës penale dhe referim i gabuar i dispozitës që gjen zbatim në rastin konkret. Përtej pranisë së elementeve të figurës së veprës penale të kanosjes, fakt ky i pohuar edhe nga subjekti i rivlerësimit në arsyetimin e tij, rezultoi se është injoruar prezenca e elementeve penale edhe për një veprë tjetër, atë të fyerjes, duke konsideruar gabimisht se ajo mund të ndiqet kryesisht nga i dëmtuari akuzues, sipas nenit 59 të K.P.P. Marrë në konsideratë se pushimi i hetimeve ndaj denoncimit të një prokurori, referuar kualifikimit të gabuar të veprës penale dhe arsyetimit ligjor, vendim i dhënë nga drejtuesi i prokurorisë, në kuadër të rivlerësimit të aftësive profesionale, merr rëndësi dhe peshë edhe më të madhe.

31.1. Kolegji vëren se më datë 10.09.2015, subjekti i rivlerësimit Besnik Cani, në cilësinë e Drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan, ka vendosur pushimin e çështjes për procedimin penal nr. {***} të vitit 2015. Në këtë vendim, subjekti ka arsyetuar se i kallëzuarit me veprimet dhe qëndrimet e tij ka kërcënuar për shkak të detyrës prokuroren A. S., por ky kërcënim në vetvete nuk përbën kanosje serioze, çfarë do të bënte që ai të ngarkohej me përgjegjësi penale. Gjithashtu në arsyetim, subjekti i rivlerësimit ka disponuar në vendimin e pushimit, se veprimet e të pandehurit përbëjnë elemente të veprës penale të fyerjes, parashikuar nga neni 119 i Kodit Penal, veprë e cila ndiqet me ankim direkt në gjykatë nga i dëmtuari akuzues, sipas nenit 59 të K.P.P.

31.2. Qenia e kallëzueses në rrethana të cilësuaras pasi kishte statusin prokurore, nuk kategorizohet te vepra penale e fyerjes sipas nenit 119 të Kodit Penal, por te veprat penale e “Fyerjes së gjyqtarit” apo “Kanosjes së gjyqtarit”, parashikuar respektivisht nga nenet 318 e 317 të Kodit Penal (në varësi të rrethanave të çështjes) ku në nenin 318 të Kodit Penal parashikohet: *Fyerja e gjyqtarit apo anëtarëve të trupit gjykues, prokurorit, avokatit ose anëtarit të arbitrazhit, për shkak të veprimtarisë së tyre në një çështje, përbën kundravajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre muaj. Si rrjedhojë, kjo çështje nuk duhet pushuar, por duhet të vijoheshin hetimet për kundravajtjen penale, që ndiqen kryesisht nga organi i prokurorisë.*

31.3. Për dy çështjet penale, atë me nr. {***} të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe atë me nr. {***} të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan, Komisioneri Publik me të drejtë kërkon që përfundimet e arritura nga Komisioni në lidhje me to të konstatohen të pabazuara dhe këto çështje të çmohen në raport me vlerësimin tërësor të rrethanave të çështjes, referuar nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016. Për sa u përket këtyre dy çështjeve penale, vlerësimi mund të kryhet sipas metodologjisë alternative, përcaktuar në vendimin nr. 21/2019 (JR) të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, duke nënvizuar argumentimin e Kolegjit në këtë vendim, ku arsyetohet se vlerësimi i kriterit të aftësive profesionale [...] kryhet duke çmuar në tërësi dhe rast pas rasti kriteret e vlerësimit të aftësive profesionale, bazuar në treguesit përkatës, sipas procedurave të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, të cilët rezultojnë të jenë të ndërthurur në tregues të natyrës cilësore dhe të vlerësueshëm, tregues të natyrës sasiore dhe të matshëm [...]. Kjo metodologji e natyrës alternative, sipas vendimit orientues, gjen zbatim [...] kur është e mundur dhe e nevojshme [...], duke përfshirë në këtë vlerësim edhe denoncimin e fakteve nga publiku, kur ekzistojnë kushtet dhe rrethanat e parashikuara në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016.

31.4. Nisur nga ky qëndrim i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, zbatimi i kësaj metodologjie alternative të vlerësimit, bazuar vetëm në këto dy çështje penale, do të ishte i pamundur.

Vlerësimi i dy çështjeve penale të lartpërmendura është bërë pjesë e shkaqeve të ankimit të Komisionerit Publik, pasi përfundimet e arritura nga Komisioni nuk janë të drejta në raport me vlerësimin tërësor të rrethanave të çështjes, në referencë të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016. Mangësitë e vërejtura nga vetë Komisioni, përfshirë këtu edhe dy çështjet e lidhura me etikën e subjektit, të trajtuara më lart, janë të tilla që nuk i përgjigjen përfundimit që ka arritur Komisioni, për t'ia transferuar organit inspektues disiplinor.

32. Lidhur me shkakun e ngritur nga Komisioneri Publik në kuadër të vlerësimit profesional që ka të bëjë me heqjen dorë nga Komisioni mbi juridiksionin e tij rivlerësues në lidhje me kriterin profesional, kur sipas Kushtetutës, Aneksit të saj dhe ligjit nr. 84/2016 është kompetencë e plotë dhe detyrë e Komisionit kryerja e rivlerësimit kalimtar të subjekteve për qëllim të nenit 179/b, pika 1 e Kushtetutës, Komisioneri Publik në ankim shprehet që përpara se Komisioni t'ia transferojë çështjet një tjetër organi kompetent për inspektim, kjo vendimmarrje duhet të udhëhiqet nga një proces paraprak vlerësimi, lidhur me plotësimin e kushteve që neni 59, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 kërkon, si “evidentimin e shkaqeve që përbëjnë shkelje disiplinore” apo “shkaqeve për t'u marrë parasysh gjatë vlerësimit periodik të subjektit”. Në çdo rast, pretendoi Komisioneri Publik, kjo lloj vendimmarrjeje e Komisionit, sipas nenit 59, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, do të duhet të kufizohet në lidhje me numrin e çështjeve/praktikave që mund t'i transferohen organit kompetent për inspektim.

32.1. Kolegji vëren se këto katër çështje, që lidhen me vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit, janë të njëjtat për të cilat Komisioni ka vendosur transferimin e tyre organit kompetent, për inspektimin e mundshëm të shkeljeve disiplinore, duke i nxjerrë jashtë juridiksionit të procesit të rivlerësimit, shkak për të cilin me të drejtë Komisioneri Publik, bazuar edhe në rekomandimin e tre vëzhguesve ndërkombëtarë të operacionit ndërkombëtar të monitorimit, i ka bërë pjesë të ankimit, duke i kërkuar Kolegjit që, bazuar në nenin 66 të ligjit nr. 84/2016, t' i marrë në shqyrtim dhe të shprehet mbi to. Kolegji gjatë zhvillimit të gjykimit të çështjes në apel, ka rezervuar të drejtën për t'u shprehur në lidhje me kërkesën e subjektit të rivlerësimit për të mos i marrë në shqyrtim këto katër çështje si më poshtë.

32.2. Në përgjigje të këtij shkak, duke vlerësuar rastin konkret, vendimin nr. 84, datë 27.11.2018, të Komisionit, për subjektin e rivlerësimit Besnik Cani, rezulton se Komisioni ka transferuar në organet përkatëse katër praktika për vlerësim dhe inspektim për ndonjë shkelje disiplinore të mundshme. Tri nga këto praktika rezultojnë të jenë procedime penale, problematikat e të cilave trajtohen rreth vendimeve të marra nga subjekti i rivlerësimit për mosfillimin e procedimeve penale, të cilat janë konstatuar me gabime në referimin e dispozitës ligjore dhe kanë vijuar të rrëzohen nga gjykata, duke urdhëruar kryerjen e veprimeve të tjera hetimore. Pra, ishin në kushte në të cilat nuk duheshin pushuar hetimet e këtyre procedimeve.

32.3. Kolegji vëren se gjenden situata të cilat janë transferuar për vlerësim në organet kompetente, përsëritja e të cilave rëndon pozitën e subjekteve të rivlerësimit në drejtim të vlerësimit profesional, si dhe bie ndesh me nenin 59, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit [...]

Komisioni ka të drejtë të transferojë çështjen pranë organit kompetent për inspektim në rast se evidenton shkaqe që përbëjnë shkelje disiplinore [...]. Ky kusht është i lidhur me konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, që do të thotë se Komisioni pasi ka bërë një hetim të thelluar, ka vendosur lejimin e subjektit që të vijojë të qëndrojë në sistemin e drejtësisë, por duke evidentuar shkaqe që mund të përbëjnë shkelje, të cilat praktikisht duhet të jenë të lehta, për sa kohë subjekti i rivlerësimit është konfirmuar, dhe nuk cenon sistemin e drejtësisë dhe besimin e publikut.

32.4. Në vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 2/2017, datë 18 janar 2017, në paragrafin 54 të tij citohet: *Në lidhje me kriteret dhe standardet për kryerjen e kontrollit të aftësive profesionale, gjykata vlerëson të theksojë edhe rëndësinë e garantimit se opinionet ligjore të shprehura nga gjyqtarët dhe/ose prokurorët, të cilat mund të konsiderohen si thjesht “të pasakta” nga kontrolluesit, të mos bëhen shkak për rezultat negativ. Është shumë e rëndësishme që vlerësimi negativ të bëhet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore dhe serioze dhe/ose kur ekziston një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara, që tregojnë mungesë të aftësive profesionale (shih edhe opinionin CDL-AD (2016)036 të Komisionit të Venecias).*

32.5. Kolegji arrin në konkluzionin, lidhur me shkakun e ankimit të mësipërm, se në rastet kur gabimet e subjekteve të rivlerësimit evidentohen që përsëriten në mënyrë të vazhdueshme dhe në praktika të ndryshme, përbëjnë përjashtim nga rastet e konfirmimit në detyrë dhe duhet të vlerësohen negativisht. Si rrjedhojë e kësaj logjike, praktikat të cilat transferohen për inspektim në organet kompetente, në parim duhet të përmbajnë shkelje joserioze, pa pasoja të rënda procedurale për palët, brenda afateve të parashikuara në nenin 117 të ligjit nr. 96/2016, si rasti i procedimit {***}, pasi në rast të kundërt do të kemi gjendje të përsëritur të gabimeve në gjykim, çka dëshmon për praninë e mangësive profesionale¹² të evidentuara të paktën në dy procedimet penale të fundit të shqyrtuara në këtë vendim dhe, që siç parashikohet në nenin 44, germa “c” e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit mund të vlerësohet “i papërshtatshëm” nga vlerësimi i aftësive profesionale, pasi në përputhje me interpretimin pajtues të vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese, konstatohen raste të gjykimeve me gabime thelbësore, serioze dhe të përsëritura. Këto gabime nga Komisioni duhen vlerësuar sipas parashikimeve të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, në funksion të nenit 4, pika 2 e të njëjtit ligj dhe, sipas nenit 66, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, Kolegji orienton Komisionin për zgjidhjen e çështjeve të ngjashme.

32.6. Kolegji, në përfundim të analizës së tij në lidhje me katër praktika të transferuara nga Komisioni në organet përkatëse për vlerësim dhe inspektim për ndonjë shkelje disiplinore të

¹² “I papërshtatshëm”, kur subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të papranueshme në punë, gjykim të dobët, nuk ka respektuar normalisht të drejtat e palëve ose viktimave, nuk është efektiv, në atë shkallë sa programi i trajnimit pranë Shkollës së Magjistraturës nuk mund ta zgjidhë këtë çështje për një vit, ose nuk ka kaluar me sukses testimin pranë Shkollës së Magjistraturës.

mundshme, nga shqyrtimi tërësor i çështjes mbi bazën e ankimit të Komisionerit Publik, situatat ligjore dhe faktike të analizuara më sipër i vlerësoi të mjaftueshme për të konkluduar edhe mbi vlerësimin tërësor të procedurave. Nisur nga sa më sipër, konsiderohet se faktet e çështjes krijojnë bindjen për të arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Besnik Cani nuk mund të gëzojë besimin e publikut për të qëndruar në detyrë dhe ndodhet në kushtet e pamundësisë për plotësimin e mangësive nëpërmjet programit të trajnimit.

**Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, bazuar në analizën e mësipërme,
arrin në këto konkluzione:**

1.1. Lidhur me shkaqet e ankimit mbi pasurinë apartament banimi me sipërfaqe 104,77 m², ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, me vlerë 8.308.261 lekë, për krijimin e së cilës Komisioneri Publik pretendoi se përfundimet e Komisionit nuk janë në pajtueshmëri me ligjin, aktet dhe provat e administruara, pasi subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë, ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e saj dhe ka kryer deklaram të pamjaftueshëm, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, Kolegji vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka pasur mungesë të burimeve të ligjshme të të ardhurave për të kursyer gjatë viteve 2005 dhe 2006, për pasojë nuk arriti të justifikojë ligjshmërinë e burimeve për krijimin e kësaj pasurie të paluajtshme në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016.

Në konkluzion, Kolegji vlerëson se subjekti i rivlerësimit është në kushtet e mungesës së burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë sipas nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

1.2. Lidhur me shkakun e ankimit mbi mosmbulimin e shpenzimeve gjatë viteve 2010-2015, Kolegji arrin në përfundimin se sipas analizës financiare, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk mund të mbulonte shpenzimet e këtyre viteve me të ardhura të ligjshme, duke krijuar pasuri apo të ardhura më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht. Për pasojë, në kuptim të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit është në kushtet e mungesës së burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë.

1.3. Lidhur me pasurinë “truall me sipërfaqe 633,8 m²”, fituar me anë të kontratës së shitjes së lidhur me ALUIZNI-n, me vendndodhje në {***}, Tiranë, për të cilën Komisioneri Publik pretendoi se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarime të ndryshme në deklaratën *vetting* dhe në ato periodike, si dhe në shpjegimet gjatë procesit të rivlerësimit, sa i përket sipërfaqes së truallit dhe banesës mbi të, duke u përpjekur kështu të paraqesë në mënyrë të pasaktë këtë pasuri, duke i bërë të zbatueshme kërkesat e nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës në lidhje me parimin e prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit të subjektit të rivlerësimit, përderisa ai nuk arriti të provojë të kundërtën, si dhe:

- lidhur me pasurinë automjet, tip “Mercedes Benz”, blerë në vitin 2012, me vlerë 1.300.000 lekë nga subjekti i rivlerësimit, për të cilën Komisioneri Publik pretendoi se për këtë pasuri nuk është deklaruar burimi i krijimit në deklaramin periodik të vitit 2012;
- lidhur me pasurinë “garazh” e ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, blerë me kontratën e shitblerjes të datës 10.04.2012, me vlerë 7.000 euro, për të cilën Komisioneri Publik pretendoi se

për këtë pasuri, ashtu si në pasurinë më sipër, nuk është deklaruar burimi i krijimit në deklarin periodik të vitit 2012;

- lidhur me huatë e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, për të cilat Komisioneri Publik pretendon se shumatat e marra dhe shlyerjet nuk përputhen me deklarinimet në deklaratat periodike dhe në atë *vetting*.

Kolegji arrin në përfundimin se, bazuar në nenin 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, në këtë situatë faktike dhe ligjore, parë në vlerësimin tërësor, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë dhe ndodhet në kushtet e pamundësisë për plotësimin e mangësive nëpërmjet programit të trajnimit.

1.4. Lidhur me kriterin e aftësive profesionale, etikës, si dhe vlerësimin tërësor të procedurave sa u përket praktikave të transferuara nga Komisioni pranë organeve kompetente për inspektimin e shkeljeve disiplinore, për të cilat Komisioneri Publik ka kërkuar nëpërmjet ankimit të shqyrtohen nga Kolegji, si:

- marrëdhënia kontraktuale ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe shoqërisë “{***}” ShPK, e lidhur më datë 27.01.2016, e ndryshuar me kontrata të tjera më pas, që krijon te publiku perceptimin se subjekti i rivlerësimit Besnik Cani nuk mund të jetë i pavarur në përmbushjen e funksionit të magjistratit;

- procedimi penal nr. {***}, i datës 31.12.2012, pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier, përfshirja e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit në mënyrë të padrejtë në listën e familjarëve të pastrehë të Këshillit Bashkiak Fier, ndërkohë që subjekti i rivlerësimit ushtronte funksionin e drejtuesit të Prokurorisë;

- procedimi penal me nr. {***} i vitit 2006, regjistruar pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për të cilin subjekti i rivlerësimit ka dhënë vendim për mosfillimin e tij, me arsyetimin se nuk konstatohet element i ndonjë veprë penale, ndërsa Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka pranuar kërkesën e kallëzuesit, duke konstatuar të gabuar vendimin “Për mosfillimin e procedimit penal”;

- procedimi penal nr. {***} i vitit 2015, regjistruar pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan, për të cilin subjekti i rivlerësimit në cilësinë e drejtuesit të Prokurorisë ka vendosur shfuqizimin e vendimit të prokurorit të çështjes për dërgimin e çështjes në gjyq, duke konsideruar fyerjen e prokurorit veprë penale, e cila ndiqet me ankim direkt në gjykatë nga i dëmtuari akuzues sipas nenit 59 të K.P.P., ndërkohë që kallëzimi penal ishte bërë nga një prokurore, veprë e cila duke qenë në rrethana të cilësuar nuk kategorizohet te vepra penale e fyerjes sipas nenit 119 të Kodit Penal;

– në vlerësimin tërësor të fakteve dhe rrethanave që përmbajnë këto praktika, Kolegji arrin në përfundimin se subjekti ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë në zbatim të neneve 61, pika 5 dhe 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 dhe ndodhet në kushtet e pamundësisë për plotësimin e mangësive nëpërmjet programit të trajnimit.

Përfundimet e mësipërme u vlerësuan nga Kolegji të mjaftueshme për të konkluduar mbi vlerësimin tërësor të procedurave. Nisur nga sa më sipër, konsiderohet se faktet e çështjes krijojnë bindjen për të arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Besnik Cani nuk mund të gëzojë besimin e publikut për të qëndruar në detyrë dhe ndodhet në kushtet e pamundësisë për plotësimin e mangësive nëpërmjet programit të trajnimit.

2. Në konkluzion të sa më sipër, Kolegji, bazuar në përfundimet e mësipërme dhe nga vlerësimi tërësor i procedurave, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarin të

pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë së tij dhe të personave të lidhur me të, në kuptim të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, neneve 33, pika 5, shkronja “b” dhe 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016; si dhe në kuptim të neneve 61, pika 5 dhe 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë. Për pasojë, vendimi nr. 84, datë 27.11.2018, i Komisionit duhet ndryshuar, pasi nuk gjendet i drejtë dhe i bazuar në fakte, prova dhe ligj.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Ndryshimin e vendimit nr. 84, datë 27.11.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Besnik Cani, prokuror në momentin e fillimit të procesit të rivlerësimit, anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë në momentin e shpalljes së këtij vendimi.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.
U shpall sot, më datë 27.02.2020, ora 10:00, në Tiranë.

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTAR

Luan DACI

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

RELATOR

Ardian HAJDARI

nënshkrimi

KRYESUESE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

MENDIM PARALEL

1. Ne, gjyqtarët Albana Shtylla dhe Sokol Çomo, anëtarë të trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim “Kolegji”) që shqyrtoi ankimin e Komisionerit Publik (në vijim “KP”) ndaj vendimit nr. 84, datë 27.11.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), që i përket subjektit të rivlerësimit Besnik Cani, dakordësohemi me vendimin e trupit gjykues, por po parashtrijmë një arsyetim paralel vetëm për një çështje të zbatimit të ligjit, të ndryshëm nga arsyetimi i anëtarëve të tjerë të trupit gjykues, në këtë vendim.
2. Arsyetimi i ndryshëm lidhet me konkluzionin e trupit gjykues sa u përket mosdeklarimeve nga subjekti i rivlerësimit të burimeve të krijimit të pasurisë së luajtshme automjet, tip “Mercedes Benz”, dhe të pasurisë së paluajtshme “garazh”, të vlerësuara nga shumica në paragrafët 24.5 dhe 25.3 si deklarime të pasakta, në interpretim të nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, por të kualifikuara për shkarkimin e tij në kuadër të cenimit të besimit të publikut, sipas nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”).
3. Bazuar në situatën faktike të provuar dhe të analizuar, si dhe në ligjin e zbatueshëm për pasuritë “Mercedes Benz” dhe “garazh”, kemi të njëjtin qëndrim me shumicën për vlerësimin e mosdeklarimeve të burimeve të krijimit të këtyre pasurive në deklaratën e interesave periodikë pasurorë (në vijim “DIPP”) të vitit 2012, si deklarime të pasakta në interpretim të nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës.
4. Lidhur me konkluzionin e shumicës për kualifikimin e deklarimeve të pasakta në DIPP, sipas nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, arsyetojmë sa vijon.

4.1 Neni 61, pika 5 e ligjit parashikon se subjektet e rivlerësimit mund të shkarkohen në rastin kur: [...] nga vlerësimi tërësor, në kuptim të nenit 4, pika 2 e këtij ligji, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë dhe ndodhet në kushtet e pamundësisë për plotësimin e mangësive nëpërmjet programit të trajnimit. Në interpretim të këtij parashikimi ligjor, në vlerësimin tonë, që cenimi i besimit të publikut të ketë ndodhur, të jetë i arsyeshëm e i konsiderueshëm apo i perceptueshëm si i tillë, duhet që të ekzistojnë shkelje që në vetvete nuk përbëjnë shkaqe për aplikimin e rasteve të tjera të shkarkimit, të parashikuara prej nenit 61, pikat 1, 2, 3 e 4 të ligjit nr. 84/2016.

4.2 Objekti i hetimit dhe i vlerësimit të pasurisë ndaj subjekteve që i nënshtrohen procesit të rivlerësimit, materializohet edhe në kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimeve të subjektit të rivlerësimit në deklaratat periodike dhe në atë të rivlerësimit kalimtar (*vetting*), ku në çdo rast subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë së tij (pasuri e paluajtshme/e luajtshme/likuiditete).

4.3 Ligji nr. 84/2016 në nenin 61, pika 3 ka përcaktuar se masa disiplinore e shkarkimit nga detyra jepet kur rezulton se subjekti ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kontrollin e pasurisë, sipas parashikimeve të nenit 33 të këtij ligji. Në interpretim të këtyre dispozitave ligjore, vlerësojmë se pamjaftueshmëria e deklaramit përfshin edhe deklarimet e pasakta të subjekteve të rivlerësimit në DIPP, apo edhe në deklaratën e rivlerësimit të pasurisë (*vetting*), por mbetet një element i cili mund të konsiderohet në vlerësimin e përgjithshëm të kriterit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit.

4.4 Në vijim të sa interpretuam më sipër, në ndryshim nga shumica, mendojmë se deklaratimet e pasakta të subjektit të rivlerësimit Besnik Cani për pasuritë “Mercedes Benz” dhe “garazh”, në zbatim të parimit të objektivitetit dhe proporcionalitetit, mund të ishin përfshirë në vlerësimin e përgjithshëm të kriterit të pasurisë dhe të kualifikoheshin sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, por nuk mund të kualifikohen për shkarkimin e tij, sipas nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

GJYQTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

GJYQTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi